

**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT- OST SH.A.**  
**DEPARTAMENTI I FINANCËS**  
**DREJTORIA EKONOMIKE**

Nr. 5.2.15.....Prot

Tiranë, më 31/08/2021

Lënda: Kërkesë për aplikim për Tarifën e Transmetimit të Energjisë Elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024

**ENTIT RREGULLATOR TË ENERJISË** ✓  
Adresa: Blvd. Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023

**I nderuar Z. Ahmeti,**

Në përputhje me (i) Ligjin nr. 43/2015 dt. 30.4.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, (ii) Metodologjinë e Llogaritjes së tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike, OST ka përgatitur “Përlllogaritjen e Tarifës për vitin kalendarik 2022 dhe periudhën 2022-2024”.

OST sh.a në llogaritjen e tarifës së transmetimit për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024, ka ndjekur me rigorozitet të drejtat dhe detyrat që ajo ka në referencë të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nën 55, 56, 60, 61, 62, 65 dhe 66, si dhe neni 2 i “Metodologjia e Llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

Ne reference të ligjit të sipërcituar neni 55, pika 1, jeni të lutur që të merrni në shqyrtim dhe të konsideroni materialin tonë për aplikimin e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për OST për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024.

Në mbështetje të kësaj kërkesë, bashkëlidhur do të gjeni:

- *Relacioni sqarues për llogaritjen e tarifës;*
- *Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë së OST sh.a., për periudhën Janar - Qershor 2021;*
- *Vlerësimet Financiare të Biznes Planit të OST sh.a. për vitet 2020-2025;*
- *Huatë Afatgjata të OST sh.a., deri në fund të muajit Qershor 2021*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në dispozicionin Tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Me respekt,

**ADMINISTRATORI I OST sh.a.**

*Skërdi Drenova*  
Skërdi Drenova



## RELACION

### PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2022 DHE PERIUDHWN 2022-2024

#### Përmbajtja

<b>I.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.</b> .....	3
<b>II.</b>	<b>Qëllimi i propozimit për rishikimin e tarifës së transmetimit.</b> .....	4
<b>III.</b>	<b>Raport i aktivitetit të OST sh.a. për Periudhën Janar-Qershor 2021</b> .....	4
<b>IV.</b>	<b>Pritshmëria e realizimit të treguesve për vitin 2021</b> .....	4
<b>V.</b>	<b>Parashikimi i kërkesës për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024</b> .....	7
<b>VI.</b>	<b>Llogaritja e tarifave të transmetimit për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024</b> ...	11
A.	Kostot kapitale.....	11
<b>VII.</b>	<b>Parshikimi i Investimeve për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024</b> .....	13
<b>VII.1</b>	<b>Projektet e Investimeve me fonde të huaja</b> .....	14
<b>VII.2</b>	<b>Projektet e Investimeve me fonde të OST</b> .....	15
B.	Kostot operuese .....	38
C.	Të ardhurat nga aktivitete të tjera.....	44
<b>VIII.</b>	<b>Tarifa aktuale</b> .....	45
<b>IX.</b>	<b>Llogaritja e Tarifave</b> .....	46
<b>IX.1</b>	<b>Llogaritja e Tarifës mesatare të transmetimit</b> .....	46
<b>IX.2</b>	<b>Ndarja e kostove në kapacitet dhe energji</b> .....	47
i.	Pagesat e kapacitetit.....	47
ii.	Pagesat e energjisë .....	49
<b>X.</b>	<b>Konkluzionet dhe efektet</b> .....	50

## I. Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. ('Shoqëria'), një Shoqëri publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit.

Shoqëria u krijua në Korrik të vitit 2004 bazuar në Vendimin nr. 797 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, datë 4 dhjetor 2003. Në bazë të këtij vendimi Shoqëria u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Sh. a ("KESH") me kapitali fillestar prej 2,000 mijë Lekë. Ndarja nga KESH u krye bazuar në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 30 qershor 2006. Shoqëria përgatiti pasqyra financiare si një njësi ekonomike e veçantë duke filluar prej 1 korrik 2006 dhe jo prej vitit 2004 kur nisën të kryheshin transaksionet e para të Shoqërisë. Në vitin 2006 Shoqëria mori liçencën për transmetim energjie nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri dhe në vijim nënshkroi një marrëveshje për shërbime transmetimi me KESH Bazuar në urdhrin nr. 329 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes ('Ministria') datë 9 maj 2008, pronësia e OST iu transferua Ministrisë. Me anë të urdherit numer 10540/17 të Ministrisë, Shoqëria, prej datës 1 janar 2008 filloi të faturonte shërbimet e saj, aktiviteti i cili me parë kryhej nepërmjet KESH. Shoqëria aktualisht e ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet 6 Njësive Operative (me qendër në Shkodër, Burrel, Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë), Njësia e Mirëmbajtjes së Transmetimit (me qendër në Tiranë) dhe Administrata Qendrore e cila është edhe selia e shoqërisë me adresë Autostrada Tiranë – Durrës, Km 9 Yrshek Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike. OST, është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Me Vendimin nr. 12 datë 08.09.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., si dhe me Vendimin nr. 130 datë 05.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratuan pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., me 57.25% të kapitalit themeltar; si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a.

Në datën 05 Tetor 2020, përfaqësuesit ligjorë të OST sh.a. dhe KOSTT sh.a., firmosën Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX.

Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX, është regjistruar tashmë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë me NIPT M02223006B. Objekti kryesor i aktivitetit të shoqërisë është krijimi, menaxhimi dhe administrimi i tregut të organizuar të energjisë elektrike, nepërmjet platformes së tregut në baze të ditës në avance dhe Brenda të njejtës dite.

## II. Qëllimi i propozimit për rishikimin e tarifës së transmetimit.

Ky aplikim, ka për qëllim të pasqyrojë nevojën për rishikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, tarifë e cila do të bëjë të mundur ushtrimin e aktivitetit normal të Operatorit të Transmetimit të Energjisë Elektrike

Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike synon të mbledhë të ardhurat e nevojshme për të zhvilluar investimet e nevojshme në sistem, për të mbuluar kostot operative të drejtimit të shoqërisë si dhe për të minimizuar humbjet në rrjetin e transmetimit.

Tarifa e transmetimit synon të shlyejë kostot e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Pronësinë, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave, kablove, nënstacioneve, transformatoreve, qendrave dispeçer dhe ndërtesave që lidhen me to si dhe facilitetet e komunikimit.
- b) Kostot e rezervave operuese të OST-së që nevojiten për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të transmetimit.
- c) Kostot e shërbimeve të tjera ndihmëse të OST-së, përfshirë pagesat e bëra OST-ve fqinje për të siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva të çastit dhe pagesat (nëse ka) për frekuencën dhe rregullimin e tensionit.
- d) Kostot e kompensimit të energjisë reaktive, që duhen alokuar në një pagesë për energjinë reaktive.
- e) Kostot për të siguruar zyra, komunikim dhe facilitete të Teknologjisë së Informacionit (IT) për Operatorin e Tregut plus kostot e personelit që lidhen me Operatorin e Tregut. Nga këndvështrimi kontabël Operatori i Tregut duhet të këtë llogaritë e tij, sikur të ishte një njësi ligjore e pavarur me të ardhura të tatueshme më vete.
- f) Pagesat e detyrimeve që vijnë nga të gjitha huatë e marra për zhvillimin e rrjetit të transmetimit.
- g) Do të mbulojë kostot e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit si dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse e të balancimit të prokuruar në treg.

## III. Raport i aktivitetit të OST sh.a. për Periudhën Janar-Qershor 2021

Referuar Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a., për vitin 2021, të miratuar së pari me Vendimin Nr. 19, datë 17.12.2020 të Këshillit Mbikqyrës së OST sh.a., si dhe miratuar me shkresën Nr. 23839/4, datë 27.01.2021 të MFE, OST sh.a. ka vijuar ushtrimin e aktivitetit të vet në funksion të plotësimin e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë së OST sh.a., për periudhën Janar - Qershor 2021, gjendet Raport më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

## IV. Pritshmëria e realizimit të treguesve për vitin 2021

Viti 2021 filloi me një kuotë rreth 273 metra në liqenin e Fierzës, një kuotë e pa favorshme për ruajtjen e një niveli normal të sigurisë së furnizimit, por prurjet mesatare mujore të lumit Drin në liqenin e Fierzës, për pese muajt e pare te vitit rezultuan mjaft me te medha se prurjet

Ilogaritese, te parashikuara me nivel sigurie 75%. Si rrjedhojë e kësaj situatë, sistemi kaloi ne regjim eksporti deri ne muajin qershor. Kapaciteti transmetues nderkufitar ka qene mese i mjaftueshem per realizimin e ketyre sasive te eksportit, si edhe per realizimin e tranziteve sipas kapaciteteve transmetuese perkatese te alokuara nga zyra rajonale CAO.

Bazuar në të dhënat e deritanishme dhe në parashikimin për muajt e ardhshëm, pritet që gjenerimi i vendit që injektohet ne rrjetin e transmetimit të jetë rreth 8 TWh, shkëmbimi total (eksport) rreth 0.5 TWh, konsumi (terheqja nga rrjeti i transmetimit) rreth 7.8 TWh perfshire humbjet në rrjetin e transmetimit me rreth 235 GWh, qe rezultojne te rritura per shkak te regjimit te punes ne eksport.

Në tabelën e mëposhtme jepen treguesit kryesorë të Prodhimit, Shkëmbimit dhe Konsumit për vitin 2021 (periudha janar – korrik me vlerat e realizuara, pjesa tjetër me vlerat e pritëshme).

Viti 2021	Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Prurja ne Fierze, me 75% siguri	m3/s	148	169	177	232	195	112	58	41	50	63	110	169	127
Prurja ne Fierze, faktike	m3/s	685	495	261	300	292	98	61	45	50	65	115	170	220
Kuota ne Fierze ne fillim te muajit	m	272.7	291.7	294.1	292.6	294.3	296.7	291.7	282.7	272.8	266.1	265.5	270.7	
Kuota ne Fierze ne fund te muajit	m	291.7	294.1	292.6	294.3	296.7	291.7	282.7	272.8	266.1	265.5	270.7	277.5	
Diferenca mesatare ditore	cm	61.2	8.6	-4.9	5.9	7.6	-16.6	-29.2	-31.9	-22.3	-2.0	17.6	21.9	1.3
Prodhimi ne Fierze	GWh	170.8	217.3	229.7	188.2	181.8	175.7	194.0	160.4	98.3	46.0	21.3	37.7	1,721
Prodhimi ne Koman	GWh	346.0	311.2	237.7	220.9	247.8	208.4	201.8	160.0	109.9	109.1	109.1	132.6	2,394
Prodhimi ne V.Dejes	GWh	132.0	123.6	123.3	112.8	124.1	98.7	97.5	79.5	55.0	62.6	63.8	81.9	1,155
Prodhimi ne Ashta	GWh	36.3	33.5	31.7	29.0	31.4	24.7	23.7	14.3	9.9	11.3	11.5	14.7	272
Prodhimi i Kaskades	GWh	685.2	685.7	622.4	550.9	585.1	507.6	517.0	414.1	273.1	228.9	205.6	266.9	5,543
Prodhimi ne HEC e Tjere	GWh	402.5	432.8	326.4	381.4	336.7	132.6	95.0	44.6	72.0	148.8	201.6	223.2	2,798
Prodhimi ne TEC	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0
Prodhimi i vendit	GWh	1088	1118	948.8	932.2	921.8	640.3	611.9	458.8	345.1	377.7	407.2	490.1	8,340
<b>Konsumi i mujor</b>	<b>GWh</b>	<b>762.4</b>	<b>654.3</b>	<b>691.1</b>	<b>643.0</b>	<b>570.0</b>	<b>585.5</b>	<b>681.4</b>	<b>682.0</b>	<b>561.1</b>	<b>600.9</b>	<b>623.2</b>	<b>787.7</b>	<b>7,843</b>
Konsumi mesatar ditor	GWh	24.6	23.4	22.3	21.4	18.4	19.5	22.0	22.0	18.7	19.4	20.8	25.4	21.5
Importi mujor	GWh	-325	-464	-258	-289	-352	-55	69	223	216	223	216	298	-498
Importi mesatar ditor	GWh	-10.5	-16.6	-8.3	-9.6	-11.3	-1.8	2.2	7.2	7.2	7.2	7.2	9.6	-1.5
Diferenca nga planifikimi mujor	GWh	9.1	10.3	9.1	13.0	12.0	15.5	30.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	8.3
Diferenca nga planifikimi ditor	GWh	0.3	0.4	0.3	0.4	0.4	0.5	1.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3
Konsumi i planifikuar, mujor	GWh	753	644	682	630	558	570	651	682	561	601	623	788	7,743
Konsumi i planifikuar, ditor	GWh	24.3	23.0	22.0	21.0	18.0	19.0	21.0	22.0	18.7	19.4	20.8	25.4	21.2

Duke marrë në konsideratë parashikimet më të fundit për periudhën e mbetur të vitit, parashikohet që Bilanci Energjetik për vitin 2021 të jetë si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Realizim							Parashikim					Viti 2021
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
<b>I.</b>	<b>Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST</b>	<b>GWh</b>	<b>1,130</b>	<b>1,133</b>	<b>990</b>	<b>977</b>	<b>960</b>	<b>784</b>	<b>837</b>	<b>821</b>	<b>683</b>	<b>725</b>	<b>754</b>	<b>915</b>	<b>10,709</b>
a)	Prodhim vendas	"	1,087	1,118	948	932	922	640	611	461	347	378	407	491	8,342
b)	Energji ne marrje	"	42	15	42	45	39	144	225	360	336	347	347	424	2,367
<b>II.</b>	<b>Energjia totale e transmetuar</b>	<b>GWh</b>	<b>1,103</b>	<b>1,105</b>	<b>970</b>	<b>954</b>	<b>937</b>	<b>769</b>	<b>820</b>	<b>804</b>	<b>668</b>	<b>709</b>	<b>737</b>	<b>897</b>	<b>10,474</b>
a)	Energji elektrike e dhene	"	368	479	300	334	390	199	156	137	120	124	130	126	2,863
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	661	567	599	524	447	478	567	580	462	490	500	645	6,519
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	74	60	72	96	100	92	97	87	86	95	107	126	1,092
<b>III.</b>	<b>Humbjet ne rrjetin e transmetimit</b>														
a)	Humbjet ne GWh	<b>GWh</b>	26	28	20	23	23	15	16	17	15	16	17	18	<b>234</b>
b)	Humbjet ne %	%	2.34%	2.44%	2.02%	2.34%	2.39%	1.90%	1.97%	2.07%	2.20%	2.21%	2.25%	1.97%	<b>2.19%</b>

*Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2021*

Në tabelën e mëposhtme, pasqyrohet rezultati financiar i pritshëm për vitin 2021.

Milionë Lekë	2021
<b>Te Ardhurat Operative</b>	
Transmetimi i energjise	5,708
Alokimi i kapaciteteve	1,448
Të ardhura nga telekomunikacioni	6
Te ardhura nga Grantet	64
Te Ardhura te Tjera	41
<b>Totali i te Ardhurave Operative</b>	<b>7,267</b>
<b>Shpenzimet Operative</b>	
Blerja e humbjeve	-1,611
Blerja e sherbimeve ndihmese	-846
Pagesë ITC	-297
Materiale të para	-118
Personeli	-1,362
Amortizimi	-2,520
Furnitoret dhe Sherbimet (Te tjere)	-538
Provizionet per debitoret	0
<b>Totali i Shpenzimeve Operative</b>	<b>-7,292</b>
<b>Rezultati Operativ</b>	<b>-25</b>
<b>Totali i te Ardhurave Financiare</b>	<b>8</b>
<b>Totali i Shpenzimeve Financiare</b>	<b>-680</b>
<b>Rezultati Financiar</b>	<b>-672</b>
<b>Fitimi para taksave</b>	<b>-697</b>
Tatim Fitimi	0
<b>Fitimi i Vitit</b>	<b>-697</b>
EBIT	-171
<b>EBITDA</b>	<b>2,503</b>


Vlerësimet Financiare të Biznes Planit të OST sh.a. për vitet 2020-2025, gjenden aneks më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

## V. Parashikimi i kërkesës për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024

Mbi bazën e të dhënave historike për dhjetë vitet e fundit, rezulton se gradienti mesatar i rritjes së kërkesës për energji elektrike, që transmetohet nëpërmjet rrjetit për OSSH dhe konsumatorët e lidhur në rrjetin e transmetimit është rreth 1%, sic paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti ↓ / muaji →	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2012	24,358	23,940	19,626	19,506	17,487	18,138	19,581	19,895	18,449	17,861	20,088	25,252	
2013	25,170	24,999	22,871	19,289	17,938	18,928	19,673	19,731	18,267	18,790	21,346	26,372	
2014	24,686	23,420	21,833	20,182	18,152	18,023	18,657	19,991	18,502	19,512	20,195	22,104	
2015	22,173	20,912	19,248	16,710	16,558	16,893	18,766	19,010	17,174	15,677	17,955	21,512	
2016	21,616	18,688	18,121	15,897	16,016	15,722	17,443	17,847	16,270	16,458	18,600	23,104	
2017	24,259	20,737	18,514	17,819	16,817	18,341	19,251	19,889	17,269	17,901	20,088	22,340	
2018	21,841	22,339	20,833	17,696	17,175	17,678	18,655	20,039	17,972	17,896	19,710	23,912	
2019	24,237	21,447	19,915	18,634	17,790	18,826	19,752	20,954	18,076	16,781	17,933	21,668	
2020	23,573	21,873	19,411	16,436	16,212	17,310	19,146	19,597	18,544	18,387	20,985	23,726	
2021	24,592	23,367	22,303	21,435	18,387	19,517	21,981						
<b>Mesatare</b>													
Rritja2012/2013	3.3%	4.4%	16.5%	-1.1%	2.6%	4.4%	0.5%	-0.8%	-1.0%	5.2%	6.3%	4.4%	3.7%
Rritja2013/2014	-1.9%	-6.3%	-4.5%	4.6%	1.2%	-4.8%	-5.2%	1.3%	1.3%	3.8%	-5.4%	-16.2%	-2.7%
Rritja2014/2015	-10.2%	-10.7%	-11.8%	-17.2%	-8.8%	-6.3%	0.6%	-4.9%	-7.2%	-19.7%	-11.1%	-2.7%	-9.2%
Rritja2015/2016	-2.5%	-10.6%	-5.9%	-4.9%	-3.3%	-6.9%	-7.1%	-6.1%	-5.3%	5.0%	3.6%	7.4%	-3.0%
Rritja2016/2017	12.2%	11.0%	2.2%	12.1%	5.0%	16.7%	10.4%	11.4%	6.1%	8.8%	8.0%	-3.3%	8.4%
Rritja2017/2018	-10.0%	7.7%	12.5%	-0.7%	2.1%	-3.6%	-3.1%	0.8%	4.1%	0.0%	-1.9%	7.0%	1.2%
Rritja2018/2019	11.0%	-4.0%	-4.4%	5.3%	3.6%	6.5%	5.9%	4.6%	0.6%	-6.2%	-9.0%	-9.4%	0.4%
Rritja2019/2020	-2.7%	2.0%	-2.5%	-11.8%	-8.9%	-8.1%	-3.1%	-6.5%	2.6%	9.6%	17.0%	9.5%	-0.2%
Rritja2020/2021	4.3%	6.8%	14.9%	30.4%	13.4%	12.7%	14.8%						13.9%
<b>Mesatare</b>	<b>0.4%</b>	<b>0.0%</b>	<b>1.9%</b>	<b>1.9%</b>	<b>0.8%</b>	<b>1.2%</b>	<b>1.5%</b>	<b>0.0%</b>	<b>0.2%</b>	<b>0.8%</b>	<b>0.9%</b>	<b>-0.4%</b>	<b>0.8%</b>
<b>Trend</b>													<b>1%</b>

Konsumi mesatar ditor ne MWh



Pra duke pranuar që rritja e pritshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST per konsum, të jetë e rendit 1%, dhe duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të cdo muaji, është bërë parashikimi i volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nëpërmjet rrjetit të transmetimit për vitin 2022, si në tabelën e mëposhtme:

Muaji		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
Mujore	GWh	766	655	693	645	580	594	683	686	573	612	635	803	<b>7,925</b>
Mesatare ditore	MWh	24,725	23,410	22,340	21,490	18,700	19,815	22,035	22,125	19,100	19,745	21,170	25,890	
Ora ↓ / Ditët →		31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	
1	MW	710	665	625	655	600	640	720	720	605	555	595	740	
2	MW	625	595	565	590	555	585	655	660	550	495	560	655	
3	MW	590	560	535	565	535	560	630	630	530	480	540	610	
4	MW	575	550	530	570	535	550	615	615	525	470	530	605	
5	MW	565	565	540	575	540	560	615	620	525	495	550	615	
6	MW	635	620	605	610	575	595	650	655	560	565	630	690	
7	MW	775	775	770	740	680	700	745	750	680	730	795	880	
8	MW	995	1,005	985	935	815	830	875	880	790	900	970	1,130	
9	MW	1,150	1,145	1,100	1,045	885	905	975	980	875	950	1,010	1,250	
10	MW	1,215	1,185	1,125	1,070	910	935	1,025	1030	915	940	995	1,250	
11	MW	1,225	1,165	1,095	1,045	900	945	1,045	1050	925	905	965	1,230	
12	MW	1,225	1,145	1,075	1,025	890	955	1,065	1070	940	895	950	1,190	
13	MW	1,230	1,135	1,065	1,020	890	955	1,080	1080	935	890	940	1,180	
14	MW	1,230	1,135	1,065	1,010	880	960	1,085	1085	935	895	950	1,190	
15	MW	1,205	1,105	1,050	995	855	935	1,065	1065	895	900	955	1,200	
16	MW	1,200	1,085	1,035	970	830	910	1,040	1040	875	915	975	1,230	
17	MW	1,240	1,100	1,035	965	825	910	1,035	1035	850	985	1,055	1,310	
18	MW	1,320	1,195	1,095	985	845	920	1,045	1045	865	1,115	1,195	1,410	
19	MW	1,335	1,270	1,205	1,025	870	935	1,060	1070	880	1,145	1,200	1,440	
20	MW	1,320	1,265	1,230	1,105	900	940	1,060	1075	990	1,090	1,170	1,425	
21	MW	1,290	1,245	1,225	1,170	960	985	1,085	1090	1,015	1,045	1,090	1,370	
22	MW	1,180	1,130	1,110	1,095	920	980	1,070	1080	915	925	985	1,260	
23	MW	1,035	975	930	950	815	880	965	970	820	805	860	1,120	
24	MW	855	795	745	775	690	745	830	830	705	655	705	910	
<b>Σ</b>	<b>MWh</b>	<b>24,725</b>	<b>23,410</b>	<b>22,340</b>	<b>21,490</b>	<b>18,700</b>	<b>19,815</b>	<b>22,035</b>	<b>22,125</b>	<b>19,100</b>	<b>19,745</b>	<b>21,170</b>	<b>25,890</b>	

Në total, pritet që konsumi bruto për vitin 2022 të jetë i rreth 7.9 TWh.

Mënyra e mbulimit të kërkesës së pritshme është bërë në bazë të eksperiencës tashmë shumë vjecare, duke konsideruar prurjet në kaskadë me 75% siguri, nivelin e liqenit në Fierzë (të pritshëm) në fillim të vitit, rritjen potenciale të numrit dhe volumit të gjenerimit të PVE-ve dhe PPE-ve, eksportin e mundshëm nga ana e tyre në varësi të kushteve të tregut të brendshëm të energjisë dhe importit të energjisë që bëhet nga ana e FTL(OSHEE) dhe konsumatorëve të kualifikuar, duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit të tyre dhe kërkesën për energji, dhe duke treguar kujdes gjithashtu për optimizimin e kaskadës së Drinit, ruajtjen e kuotës në Fierzë, pra efijencën e gjenerimit, si dhe fillimin e vitit tjetër me një kuotë dhe rezervë energjetike optimale për të perballuar kërkesën për energji elektrike.

Parashikimi i parametrave kryesore dhe llogaritjet përkatëse janë të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.



Viti 2022	Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Prurja ne Fierze, me 75% siguri	m3/s	148	169	177	232	194.75	112	58	41	50	63	110	169	127
Prurja ne Fierze, faktike	m3/s	150	170	180	235	195	115	60	45	50	65	115	170	129
Kuota ne Fierze ne fillim te muajit	m	280.0	285.7	289.5	290.0	293.1	297.0	296.6	292.1	285.0	279.7	277.1	278.5	
Kuota ne Fierze ne fund te muajit	m	285.7	289.5	290.0	293.1	297.0	296.6	292.1	285.0	279.7	277.1	278.5	284.1	
Diferenca mesatare ditore	cm	18.5	13.4	1.6	10.5	12.6	-1.2	-14.7	-22.9	-17.6	-8.3	4.8	17.9	1.2
Prodhimi ne Fierze	GWh	26.4	51.6	126.8	112.2	67.1	92.1	137.7	158.8	114.8	80.2	59.8	47.6	1,075
Prodhimi ne Koman	GWh	229.7	181.6	165.1	164.4	153.8	143.9	151.5	149.3	111.5	134.6	142.4	138.1	1,866
Prodhimi ne V.Dejes	GWh	161.4	121.5	87.3	86.2	80.3	71.9	75.3	74.3	55.8	75.0	80.0	84.6	1,054
Prodhimi ne Ashta	GWh	29.0	21.9	15.7	15.5	14.4	12.9	13.6	13.4	10.0	13.5	14.4	15.2	190
Prodhimi i Kaskades	GWh	446.5	376.6	394.9	378.3	315.6	320.8	378.0	395.7	292.2	303.3	296.7	285.5	4,184
Prodhimi ne HEC e Tjere	GWh	171.1	211.7	260.4	230.4	226.9	129.6	81.8	67.0	64.8	85.6	122.4	219.5	1,871
Prodhimi ne TEC	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0
Prodhimi i vendit	GWh	618	588	655.3	608.7	542.5	450.4	459.9	462.7	357.0	388.9	419.1	505.0	6,055
<b>Konsumi i mujor</b>	<b>GWh</b>	<b>766.5</b>	<b>655.5</b>	<b>692.5</b>	<b>644.7</b>	<b>579.7</b>	<b>594.4</b>	<b>683.1</b>	<b>685.9</b>	<b>573.0</b>	<b>612.1</b>	<b>635.1</b>	<b>802.6</b>	<b>7,925</b>
Konsumi mesatar ditore	GWh	24.7	23.4	22.3	21.5	18.7	19.8	22.0	22.1	19.1	19.7	21.2	25.9	21.7
Importi mujor	GWh	149	67	37	36	37	144	223	223	216	223	216	298	1,870
Importi mesatar ditore	GWh	4.8	2.4	1.2	1.2	1.2	4.8	7.2	7.2	7.2	7.2	7.2	9.6	5.1
Diferenca nga planifikimi mujor	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Diferenca nga planifikimi ditore	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Konsumi i planifikuar, mujor	GWh	766	655	693	645	580	594	683	686	573	612	635	803	7,925
Konsumi i planifikuar, ditore	GWh	24.7	23.4	22.3	21.5	18.7	19.8	22.0	22.1	19.1	19.7	21.2	25.9	21.7

Nga llogaritjet, me probabilitetin e pranuar të prurjeve në kaskadën e Drinit, (prurja mesatare vjetore në Fierzë 130 m3/s, në Koman 70 m3/s, në V.Dejes 20 m3/s), rezulton se prodhimi i pritshëm i kaskadës (pjesa e KESH) është i rendit 3.9 TWh, prodhimi i centraleve me koncesion dhe atyre private pritët të jetë rreth 2.1 TWh. Pjesa tjetër e energjisë e nevojshme për të mbuluar kërkesën për energji elektrike duhet të importohet, dhe pritët që fizikisht importi nga interkoneksioni të jete i rendit 1.9 TWh.

Importi i energjisë nga OSHEE për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe nga Furnizuesit e Kualifikuar për konsumatorët respektivë, është kalkuluar në mënyrë komplementare me probabilitetin e përzgjedhur të prodhimit nga hidrocentralet e vendit. Ndryshimi i sasisë vjetore të importit që mund të diktohet nga ndryshimi i prodhimit të vendit si rrjedhojë e ndryshimeve të situatës hidrike, sic e ka treguar eksperiencia e deritanishme, nuk e ndryshon planifikimin e kërkesës për energji elektrike.

Bazuar në të dhënat historike, dhe duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit dhe volumit të kërkesës së Konsumatorëve të Kualifikuar, prodhimin e PVE dhe PPE, si dhe sasinë e energjisë që nevojitet për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit, është plotësuar tabela e bilancit të energjisë për vitin 2022 si më poshtë:

Nr.	Emertimi	Njesia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2022
<b>I.</b>	<b>Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST</b>	<b>GWh</b>	<b>946</b>	<b>815</b>	<b>858</b>	<b>770</b>	<b>695</b>	<b>739</b>	<b>808</b>	<b>791</b>	<b>658</b>	<b>837</b>	<b>730</b>	<b>903</b>	<b>9,550</b>
a)	Prodhim vendas	"	617	589	655	609	542	451	459	462	357	389	419	505	6,054
b)	Energji ne marrje	"	329	226	203	161	153	288	349	329	301	448	311	398	3,496
<b>II.</b>	<b>Energjia totale e transmetuar</b>	<b>GWh</b>	<b>927</b>	<b>799</b>	<b>841</b>	<b>754</b>	<b>679</b>	<b>722</b>	<b>790</b>	<b>773</b>	<b>643</b>	<b>821</b>	<b>712</b>	<b>884</b>	<b>9,345</b>
a)	Energji elektrike e dhene	"	180	160	165	125	115	145	125	105	85	225	95	100	1,625
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	657	564	586	524	454	477	565	578	473	501	512	659	6,550
c)	Energji elektrike per konsumatorët e kualifikuar	"	90	75	90	105	110	100	100	90	85	95	105	125	1,170
<b>III.</b>	<b>Humbjet ne rrjetin e transmetimit</b>														
a)	Humbjet ne GWh	GWh	19	16	17	16	16	17	18	18	15	16	18	19	205
b)	Humbjet ne %	%	2.01%	1.96%	1.98%	2.08%	2.30%	2.30%	2.23%	2.28%	2.28%	1.90%	2.45%	2.15%	2.15%

Me të njëjtën mënyrë llogaritjeje, pra bazuar në të dhënat historike, është bërë parashikimi i bilancit energjetik për vitet në vazhdim, si në tabelat e mëposhtme:

Nr.	Emertimi	Njesia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2023
<b>I.</b>	<b>Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST</b>	<b>GWh</b>	<b>879</b>	<b>797</b>	<b>853</b>	<b>806</b>	<b>811</b>	<b>702</b>	<b>703</b>	<b>728</b>	<b>616</b>	<b>787</b>	<b>883</b>	<b>1050</b>	<b>9,615</b>
a)	Prodhim vendas	"	570	580	680	610	555	450	390	360	300	400	450	610	5,955
b)	Energji ne marrje	"	309	217	173	196	256	252	313	368	316	387	433	440	3,660
<b>II.</b>	<b>Energjia totale e transmetuar</b>	<b>GWh</b>	<b>860</b>	<b>780</b>	<b>835</b>	<b>790</b>	<b>795</b>	<b>685</b>	<b>685</b>	<b>710</b>	<b>600</b>	<b>770</b>	<b>865</b>	<b>1,030</b>	<b>9,405</b>
a)	Energji elektrike e dhene	"	95	125	140	170	240	120	20	35	40	165	235	225	1,610
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	670	570	600	530	470	485	580	590	480	510	520	680	6,685
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	95	85	95	90	85	80	85	85	80	95	110	125	1,110
<b>III.</b>	<b>Humbjet ne rrjetin e transmetimit</b>														
a)	Humbjet ne GWh	<b>GWh</b>	19	17	18	16	16	17	18	18	16	17	18	20	210
b)	Humbjet ne %	%	2.16%	2.13%	2.11%	1.99%	1.97%	2.42%	2.56%	2.47%	2.60%	2.16%	2.04%	1.90%	2.18%

Nr.	Emertimi	Njesia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2024
<b>I.</b>	<b>Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST</b>	<b>GWh</b>	<b>900</b>	<b>808</b>	<b>933</b>	<b>866</b>	<b>796</b>	<b>712</b>	<b>713</b>	<b>709</b>	<b>637</b>	<b>797</b>	<b>889</b>	<b>1065</b>	<b>9,825</b>
a)	Prodhim vendas	"	615	585	685	615	595	460	400	370	310	410	460	620	6,125
b)	Energji ne marrje	"	285	223	248	251	201	252	313	339	327	387	429	445	3,700
<b>II.</b>	<b>Energjia totale e transmetuar</b>	<b>GWh</b>	<b>880</b>	<b>790</b>	<b>915</b>	<b>850</b>	<b>780</b>	<b>695</b>	<b>695</b>	<b>690</b>	<b>620</b>	<b>780</b>	<b>870</b>	<b>1,045</b>	<b>9,610</b>
a)	Energji elektrike e dhene	"	105	120	220	230	220	125	15	5	55	170	240	235	1,740
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	675	580	600	530	470	485	590	595	480	510	520	685	6,720
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	100	90	95	90	90	85	90	90	85	100	110	125	1,150
<b>III.</b>	<b>Humbjet ne rrjetin e transmetimit</b>														
a)	Humbjet ne GWh	<b>GWh</b>	20	18	18	16	16	17	18	19	17	17	19	20	215
b)	Humbjet ne %	%	2.22%	2.23%	1.93%	1.85%	2.01%	2.39%	2.52%	2.68%	2.67%	2.13%	2.14%	1.88%	2.19%

Tabela e mëposhtme pasqyron parashikimet e Bilancit të energjisë për vitet 2022-2024

	Njesia	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Prodhimi Vendas TOTAL	GWh	8,077	4,767	4,892	8,342	6,054	5,955	6,125
Energji ne Marrje	GWh	1,772	3,177	3,239	2,367	3,496	3,660	3,700
<b>ENERGJI TOTALE NË SISTEMIN E OST</b>	<b>GWh</b>	<b>9,848</b>	<b>7,943</b>	<b>8,131</b>	<b>10,709</b>	<b>9,550</b>	<b>9,615</b>	<b>9,825</b>
Transmetuar OSHEE	"	5,963	6,137	6,184	6,519	6,550	6,685	6,720
Transmetuar KK	"	957	867	811	1,092	1,170	1,110	1,150
Konsumi		6,921	7,004	6,996	7,611	7,720	7,795	7,870
Energji ne dhenie	GWh	2,685	770	963	2,863	1,625	1,610	1,740
<b>ENERGJI TRANSMETUAR NGA OST</b>	<b>GWh</b>	<b>9,606</b>	<b>7,775</b>	<b>7,959</b>	<b>10,474</b>	<b>9,345</b>	<b>9,405</b>	<b>9,610</b>
Humbjet ne rrjet	GWh	243	169	172	234	205	210	215
Humbjet ne rrjet	%	2.46%	2.13%	2.12%	2.19%	2.15%	2.18%	2.19%

## VI. Llogaritja e tarifave të transmetimit për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024

Në përputhje me metodologjinë, OST sh.a.ka bërë perlllogaritjet për të ardhurat e kërkuara dhe kostot totale ajo do të perballojë gjatë gjithë vitit 2022 dhe periudhës 2022-2024.

Niveli i synuar i të ardhurave që kërkohen nga OST do të mbulojë të gjitha kostot e lejuara nga Metodologjia e Transmetimit të Energjisë Elektrike respektivisht kostot e kapitalit dhe kostot operative.

**Niveli i synuar i të ardhurave që do të mblidhen gjatë vitit bazë është i barabartë me:**

$$C = C_{\text{kapitale}} + C_{\text{operuese}}$$

### A. Kostot kapitale

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në përputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik në tërësi është një nga funksionet themelore të OST dhe përbën një domosdoshmëri për kryerjen e funksioneve të saj.

Gjatë viteve të fundit janë kryer një sërë studimesh të sistemit të transmetimit që kanë përcaktuar projektet kryesore të nevojshme për zhvillimin e tij. Disa nga këto projekte janë në fazë implementimi dhe të tjerë, për të cilët është siguruar financimi nga institucione financiare ndërkombëtare do të vihen në zbatim në një periudhë kohore të përcaktuar.

Rrjeti i transmetimit ka një shtrirje të gjerë në të gjithë territorin e vendit. Në pjesën 110 kV janë lidhur nënstacionet transformuese 110/TM kV, të cilët furnizojnë me energji elektrike të gjitha zonat urbane të vendit. Gjithashtu në zbarat e nenstacioneve 110 kV pranë zonave me burime hidrike janë lidhur një numër i rëndësishëm i HEC-eve të rinj.

OST gjithmonë ka mundur të transmetojë gjenerimin e plotë të vendit pa asnjë kufizim dhe me nivel të lartë sigurie, por në vitet e fundit jemi gjendur përballë një rritje të gjenerimit të vendit të rendit rreth 30 % më të lartë nga ajo e maksimumit të arritur më parë. Kjo, për shkak se ne rrjetin e sistemit elektroenergjetik (rrjetin e shpërndarjes dhe të transmetimit) janë futur një numër i madh gjeneruesish të rinj. Praktika e operimit në këtë situatë ekstreme nxori në pah disa nyje kritike të sistemit të transmetimit të cilat paraqiten më poshtë.

Gjithashtu, pjesa më e madhe e rrjetit 110 kV përfshirë linjat dhe nënstacionet e lidhur në të, kanë tashmë një periudhë shfrytëzimi rreth 50 vjeçare.

Mbi bazën e evidentimeve të sakta janë bërë ndërhyrje të thella në linjat kryesore të transmetimit që njëkohësisht kalojnë në terrene malore dhe me kushte mjaft të vështira të motit në periudhën e dimrit. Ndërhyrjet kanë konsistuar në përforcimet e konstruksioneve të shtyllave duke plotësuar elementet e hequr nga keqbërësit, ndërrimin e izolatorëve të dëmtuar, riparimin e defekteve në percjellës dhe në raste të caktuara zëvendësimin e tij.

Megjithë masat e mësipërme, në pjesën më të madhe të rrjetit 110 kV nuk janë bërë ndërhyrje rehabilituese të thella dhe shkalla e amortizimit të pajisjeve të tyre është tepër e lartë. Nga evidencimi ka dal në pah se:

- Elementët konstruktivë të linjave janë tejet të amortizuara dhe me kapacitet të ulët.
- Ndërtimet informale poshtë linjave të vjetëruara e rrisin riskun e demtimeve nga rryma elektrike.
- Mbingarkimi i linjave shumë pranë limiteve të qëndrueshmërisë termike.
- Në disa nënstacionë paisjet primare (çelsa, thika) nuk komutohen dhe disa prej tyre janë të shuntuar.
- Sistemi i zbarave është me përcjellës me kapacitet të ulët dhe amortizimi i morsetave lidhëse është tepër i lartë.
- Konstruksionet metalike të paisjeve janë të koroduara, sistemi i tokëzimit gjithashtu.
- Sistemi i mbrojtjes rele është me paisje të vjetëruara që tashmë nuk përdoren më. Ai nuk është i sigurtë, nuk vepron në mënyrë selektive dhe në shumë raste nuk reagon fare.
- Sistemet e kontrollit lokal janë jashtë funksionit dhe manovrimet në disa raste bëhen vetëm në fushë, disa prej këtyre nënstacioneve nuk përfshihen në sistemin SCADA të Qëndres Kombëtare Dispecer.

Si rezultat i kësaj gjëndjeje kemi pasoja në:

- Mungesën e elementëve komutues, që redukton fleksibilitetin e operimit të skemës dhe shpesh bëhet shkak për ndërprerje të furnizimit të konsumatorëve për kryerjen e monovrimeve që janë të nevojshme për operimin në kohë reale.
- Rrezikun me të cilin ndeshet personeli operativ gjatë manovrimit të rrjetit.
- Vështirësi në identifikimin e difekteve në linjat 110 kV, kjo për shkak të mungesës së selektivitetit dhe identifikimit të zonës ku është dëmtuar linja.
- Ndërprerje të furnizimit me energji të konsumatorëve apo të gjenerimeve të HEC-eve lokale, për shkak të demtimeve të shpeshta në rrjet dhe në paisjet e nënstacioneve.
- Rritje të numrit të stakimeve
- Kohë më e gjatë për kryerjen e remonteve.
- Operimin e rrjetit me humbje më të medha.
- Etj.


Nisur nga sa më sipër shohim të nevojshme kryerjen e ndërhyrjeve rehabilituese në disa prej linjave 110 kV të rrjetit të transmetimit duke marrë në konsideratë:

- a) Shkalla e amortizimit të linjave dhe impianteve të nënstacioneve 110 kV.
- b) Rëndësia që kanë linjat dhe nënstacionet 110 kV për operimin në kohë reale dhe rritjen e fleksibilitetit të rrjetit 110 kV.
- c) Mos plotësimi i kriterit të sigurisë statike N-1.
- d) Ecuria me të njëjtën linjë me zhvillimin e Sektorit të Energjisë Elektrike

Rankimi i projekteve sipas prioritetit që ato përfaqësojnë, duke filluar nga ato më emergjentet (afat-shkurtër), afat-mesëm dhe afat-gjatë.

## VII. Parshikimi i Investimeve për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024

Gjatë viteve 2022-2024, OST sh.a., parashikon të kryejë rreth 16.5 miliardë lekë investime, nga të cilat, rreth 44.3 % të financuara me fonde të huaja, ndërsa pjesa tjetër parashikohet të bëhet me fondet e OST sh.a..



Në mënyrë të përmblodhur, programi i investimeve për këtë periudhë paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

	2022			2023			2024		
	Kosto e Huaj	Kosto Lokale	TOTAL	Kosto e Huaj	Kosto Lokale	TOTAL	Kosto e Huaj	Kosto Lokale	TOTAL
<b>Projekte te Financuar nga Donatoret</b>	<b>3,811</b>	<b>14</b>	<b>3,825</b>	<b>2,214</b>	<b>0</b>	<b>2,214</b>	<b>1,311</b>	<b>0</b>	<b>1,311</b>
Eficienta e Energjisë	2,126	14	2,140			0			0
Linja 400kV Elbasan - Bitola	1,686		1,686	2,214		2,214	1,311		1,311
<b>Projekte te Financuar nga OST</b>	<b>0</b>	<b>3,093</b>	<b>3,093</b>	<b>0</b>	<b>3,087</b>	<b>3,087</b>	<b>0</b>	<b>3,032</b>	<b>3,032</b>
Programi afatmesem i OST sh.a.		2,763	2,763		2,657	2,657		2,532	2,532
Rikonstruksioni i N/St		150	150		250	250		400	400
Investime ne rast emergjencash		180	180		180	180		100	100
<b>TSO TOTAL INVESTMENTS</b>	<b>3,811</b>	<b>3,107</b>	<b>6,918</b>	<b>2,214</b>	<b>3,087</b>	<b>5,301</b>	<b>1,311</b>	<b>3,032</b>	<b>4,343</b>

Në vijim tregohen disa nga investimet që do të ndiqen gjatë kësaj periudhe.

## VII.1 Projektet e Investimeve me fonde të huaja

### **PROJEKTI “PROGRAMI I EFICËNCËS SË ENERGJISË TË SEKTORIT TË TRANSMETIMIT” -LOTI 1- NËNSTACIONET DHE LOT 2- LINJAT**

**FINANCIMI:** Ky projekt financohet nga një kredi prej 40,000,000.00 Euro e akorduar nga Qeveria Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW.

**PËRFITIMET:** Ky projekt do të bëjë të mundur rritjen e besueshmërisë së funksionimit të rrjetit 220 kV të rajonit të Durrësit dhe të Jugut të Shqipërisë duke plotësuar kriteret teknike të sigurisë dhe cilësisë. Gjithashtu ky projekt do të përmirësojnë kushtet aktuale të furnizimit me energji elektrike të qytetit të Tiranës, duke konsideruar që një pjesë e rëndësishme e rrjetit unazor 110 kV që furnizon me energji elektrike nënstacionet e sistemit të shpërndarjes në zonën e Tiranës, i ndërtuar përpara mbi 40 vjetësh i përbërë nga linja ajrore të amortizuara dhe kapacitetet transmetimi të limituar.

### **NDËRTIMI I LINJËS SË INTERKONJEKSIONIT 400 KV ELBASAN2 (SHQIPËRI) – BITOLA (MAQEDONI) DHE ELBASAN2 – FIER SI DHE SI DHE ZGJERIMI I NËNSTACIONEVE ELBASAN2 DHE FIER**

**FINANCIMI:** Financimi i këtij projekti, do të sigurohet nga Bashkëpunimi Gjermano-Shqiptar i Zhvillimit. Tashmë janë angazhuar fondet për një kredi të zhvillimit deri në 50.000.000 Euro për Qeverinë Shqiptare. Përveç kësaj, për të mbuluar financimin e plotë të projektit, do të vihet në dispozicion një grant nga WBIF prej 13.720.000 Euro. Gjithashtu, rreth 1.131.000 Euro, do të angazhohen nga WBIF dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Gjermano-Shqiptar, fonde të cilat do të përdoren për përgatitjen e dizajnit kryesor. OST sh.a., është angazhuar të mbulojë gjatë implementimit të projektit dhe kostot lokale, të cilat janë përlllogaritur të jenë rreth 5 milion Euro.

**PËRFITIMET:** Ky projekt përforcon lidhjet interkonektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike, dhe si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian.

## VII.2 Projektet e Investimeve me fonde të OST

### NDËRTIMI I LINJËS SË RE 110 KV FIER-HOXHARË

OSHEE në përputhje me iniciativën paraprake të MIE në funksion të mbështetjes së zhvillimit infrastrukturor dhe projekteve të afërta strategjike në zonën e Hoxharës do të ndërtojë Nënstacionin elektrik të Hoxharës me nivele tensioni 110/35/20 kV dhe fuqi transformatorike 1x40/50MVA.

Nga ana e OST sh.a., për furnizimin me energji elektrike të Nënstacionit të ri të Hoxharës parashikohet ndërtimi i një linje të re 110 kV, me gjatësi rreth 18 km dhe me përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup>, nga N/Stacioni Fier 220/110/35 kV ku do të instalohet trakti 110 kV i linjës së re.

#### PËRFITIMET:


- Rrit sigurinë e furnizimit me energji elektrike të sistemeve të hidrovorëve në zonën e Hoxharës;
- Mbështet zbatimin e projektit strategjik TAP në zonën e Hoxharës nëpërmjet garantimit të furnizimit me energji elektrike të stacionit të kompresorëve të gazit që planifikohet të ndërtohet në verilindje të qytetit të Fierit, rreth 2 km në veri të fshatit Sheq Marinës.
- Rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike për rrjetin 35 kV dhe abonentëve familjarë.
- Ndihmon në zhvillimin e sektorit të turizmit, pjesë e politikave zhvillimore të vendit.
- Mbështet e politikat për diversifikimin e burimeve të rinovueshme nëpërmjet rritjes së kapaciteteve transmetuese për burimet e rinovueshme të energjisë elektrike, kryesisht nga impiantet që shfrytëzojnë energjinë diellore, me fuqi të përgjithshme deri në 40 MVA në zonë.

### NDËRTIMI I LINJËS RE KABLLORE TIRANA1-QËNDËR

Nënstacioni Tirana Qëndër 110/20 kV do i nënshtrohet një zhvendosje me të gjithë asetet e saj. Parashikohet spostimi dhe ndërtimi i një stacioni të ri, Tirana Qender e Re i cili do të zëvendësojë nënstationin ekzistues të Qendrës 1x60/80MVA. Për energjizimin e N/Stacionit të Ri të Qendrës që parashikohet të ndërtohet me kapacitet 2x63/80MVA do të shfrytëzohet zgjatimi i linjës ekzistuese L-110-43 e ndërtuar me kabëll alumini 800 mm<sup>2</sup> që del nga seksioni i dytë i anës 110 kV të N/Stacionit Tirana1 si dhe një linjë e re kabllorë me seksion 1000 mm<sup>2</sup> me gjatësi rreth 2.2 km e cila do të dalë nga seksioni i parë i anës 110 kV të N/stacionit Tirana1.



Diagrama e lidhjes së N/Stacionit të Ri të Qendrës



*Pozicioni i N/stacionit të Ri të Qëndres.*

#### PËRFITIMET:

- Linja e re do të rrisë sigurinë e furnizimit të N/Stacionit 110/20 kV të Ri të Qëndrës i cili furnizon me energji konsumatorë të rëndësishëm së veçantë ku përveç godinave qeveritare mbulon dhe një numër të madh të bizneseve të vogla e të mesme.
- Rritjen e sigurisë së furnizimit në tërësi të rrjetit unazor 20kV të shpërndarjes të Rajonit të Tiranës për shkak se fiderat dalës 20kV nga Nstacioni Qender operojnë në unazë me fidera dalës nga n/stacionet 110kV të Traktorave, Selitë dhe Tirana1.


#### **ZGJERIMI N/ST TIRANA1 TR 220/20 63 MVA (TRAKTI 220 KV, SEKSIONI TRETË 20 KV DHE BAZAMENTI TR 63MVA )**

Nënstacioni Tirana1, i ndërtuar në vitin 1972 është rikonstruktuar plotësisht në vitin 2011. Ai është i pajisur me tre autotransformatorë 220/110/35 kV me fuqi të instaluar 120 MVA secili si dhe dy transformatorë 220/20 kV me fuqi të instaluar 63 MVA secili, ana 20kV e të cilëve mbulon një pjesë të rëndësishme të rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Tiranës. Zhvillimi i ngarkesës së transformatorëve të fuqisë 220/20 kV të nënstacionit elektrik Tirana-1, është e lidhur ngushtë me planin zhvillimor të ngarkesës dhe të rrjetit 20kV të qytetit të Tiranës.

Aktualisht, nga analiza e bërë mbi bazën e ngarkesave maksimale të realizuara në vitet 2017-2018-2019, rezulton se dalja nga operimi i njërit prej transformatorëve 220/20 kV në nënstacionin Tirana1, mbingarkon transformatorin tjetër deri në 166% për vitin 2019, pra nuk kemi plotësim të kriterit të sigurisë N-1 për këta transformatorë.

Nga analiza e të dhënave të siguruar dhe nga llogaritjet e bëra për këtë qëllim, del se instalimi i një transformatori të ri 220/20kV me fuqi 63 MVA, do të shërbëjë rritjes së sigurisë së furnizimit dhe operimit duke shërbyer si rezervë sigurie në rast të daljes eventuale jashtë pune të njërit prej transformatorëve ekzistues.





*Transformatori i ri shtesë 220/20kV, 63MVA në Tirana1.*

#### **PËRFITIMET:**

- Rritjen e sigurisë së furnizimit dhe operimit duke shërbyer si rezervë sigurie në rast të daljes eventuale jashtë pune të njërit prej transformatorëve ekzistues.
- Rritjen e sigurisë së furnizimit në tërësi të rrjetit unazor 20kV të shpërndarjes të Rajonit të Tiranës për shkak se fiderat dalës 20kV nga nënstationi Tirana1 janë në lidhje unazore me fiderat dalës nga n/stacionet 110kV të Traktorave, Selitë dhe Qendër.

#### **NDËRTIMI I LINJËS RE 110 KV GJIRI LALZIT -F.KUQE**

Ndërtimi i Nënstationit të Gjirit të Lalzit 110/20 kV nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet operatorëve për zhvillimin e rrjetit elektrik, OST sh.a. ndërmori investimin për ndërtimin e linjës 110 kV N/Stacioni Sallmone - Gjiri i Lalzit si dhe një trakti 110 kV në N/Stacionin Sallmone të cilat u vendosën në operim në vitin 2020.

Zona e Gjirit të Lalzit është një zonë me potenciale të mëdha turistike dhe ndërtimi i infrastrukturës së re energjitike do të nxisë investimet e reja në turizëm dhe rritjen e numrit të bizneseve të vogla e të mesme duke gjallëruar ekonominë lokale në drejtim të shtimit të prodhimeve bujqësore, blegtorale etj. Gjithashtu kjo linjë do të shërbejë për rritjen e kapaciteteve transmetuese për burimet e rinovueshme të energjisë elektrike të mundshme në zonë, sidomos për impiantet solare të cilat janë në fokus zhvillimi etj.

Për të përmbushur kriterin e sigurisë statike N-1 dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike në N/Stacionin Gjiri i Lalzit është e nevojshme operimi në unazë për anën 110 kV.

Parashikohet ndërtimi i një linjë të re 110 kV Gjiri i Lalzit - F.Kuqe, me gjatësi rreth 23 km dhe me përcjellës ACSR-240 mm<sup>2</sup>. Realizimi i kësaj linje do të sjellë operimin në unazë të të N/Stacionit të Gjirit të Lalzit.




Diagrama njëfazore e lidhjes së Nënstacioneve Gjiri i Lalzit dhe Fushë Kuqe me një linjë të re 110kV.

#### PËRFITIMET:

- Përmirëson në mënyrë të ndjeshme situatën duke përballuar kërkesën gjithnjë e në rritje për energji elektrike të subjekteve në këtë zonë;
- Ul ngarkesën në rrjetin ekzistues;
- Përmirëson ndjeshëm profilin e tensioneve duke garantuar furnizim me cilësi të konsumatorëve.
- Lejon zhvillimin perspektiv të rrjetit në të ardhmen.

#### NDËRTIMI N/ST TË RI 110/35/20 KV PALASË DHE LINJËS 110 KV

Në kuadër të bashkëpunimit si përgjigje të kërkesës nga OSHEE për planifikimin e zhvillimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për shkak të zhvillimit të resorteve turistike në zonën e Palasë-Dhërmi-Himarë dhe të kërkesës së MIE për marrjen e masave paraprake nga OST për plotësimin e nevojave për furnizimin me energji elektrike të Tunelit të Llogarasë, strukturat përgjegjëse të OST kanë vlerësuar situatën aktuale të infrastrukturës elektroenergjitike në zonën e Himarë-Palasës dhe mundësinë e zhvillimit të saj në përputhje me planet zhvillimore të ngarkesës të paraqitur nga OSHEE dhe të MIE dhe propozon këto masa paraprake të ndarë në dy faza. Në fazën e parë:

- Të realizohet ndërtimi i Nënstacionit të ri 110/35/20 kV Palasë me fuqi 25/12.5/20 MVA dhe kthimi i njërit qark të linjës ekzistuese që aktualisht është në operim në nivel tensioni 10 kV në linjë 110 kV sikundër është parashikuar. Kjo linjë do të duhet të zgjatet nga N/Stacioni 35/10 kV Palasë deri në sheshin e ri ku do të përcaktohet për ndërtimin e nënstationit të ri të Palasës. Kjo linjë në total është rreth 13 km dhe ka gjithsej 45 shtylla.


Në varësi të sheshit ku do të vendoset të ndërtohet Nënstacioni i ri 110/35/20 kV Palasë do të duhet të ndërtohet linja 110 kV me dy qarqe nga N/Stacioni 35/10 kV Palasë (shtylla nr. 45) deri tek sheshi i nënstationit të ri. Një shesh i përshtatshëm për ndërtimin e nënstationit të ri mund të jetë zona si në figurëm në vijim.



*Pozicionimi i Nënstacionit të ri 11035/20 kV Palas dhe segmenti i ri i linjës 110 kV me dy qarqe.*  
 Nëse ky do të përdorej si shesh për nënstationin, linja e re 110 kV që duhet të ndërtohet është afërsisht 3 km. Gjithashtu në këtë investim parashikohet instalimi i një trakti të ri për këtë linjë në Nënstacionin 110/35/20 kV Himarë.

Linja kabllore 35 kV ndërmjet N/Stacioneve Himarë e re – Himarë e vjetër e cila aktualisht përdoret si segment i linjës 10 kV Himarë e vjetër – Palas mund të përdoret si linjë 35 kV (qarku i dytë) Himarë e re – Himarë e vjetër.

Në përfundim të fazës së parë rrjeti do të ketë konfigurimin si në figurën në vijim:



Për të bërë të mundur realizimin e fazës së parë është e nevojshme të investohet për realizimin e këtyre punimeve:

- Ndërtimi i N/Stacionit të ri 110/35/20 kV në Palasë.
- Ndërtimi i segmentit të linjës 110 kV me dy qarqe me gjatësi rreth 3 km, njëri qark 110 kV dhe qarku i dytë 35 kV.

Kthimi i linjës ekzistuese Himarë-Palasë (qarku që shfrytëzohet aktualisht si linjë me tension 10 kV) me izolacion 110 kV.

#### **PËRFITIMET:**

- Përmirëson në mënyrë të ndjeshme situatën duke përballuar kërkesën gjithnjë e në rritje për energji elektrike të subjekteve në këtë zonë;
- Ul ngarkesën në rrjetin ekzistues të shpërndarjes në nivelin 35 kV dhe 10 kV dhe e bën atë më efektiv e fleksibel duke rritur performancën e shërbimit.
- Mbyll në unazë rrjetin 35 kV dhe bën rezervimin e N/Stacioneve Palasë 35/10 kV dhe Himarë e vjetër 35/10 kV.
- Përmirëson ndjeshëm profilin e tensioneve duke garantuar furnizim me cilësi të konsumatorëve.
- Bën efektiv një investim të bërë nga OSHEE vitet e fundit, linjën 110 kV me dy qarqe që del nga nënstacioni 110/35/20 kV Himarë e re dhe përfundon në nënstacionin 35/10 kV Palasë. Kjo linjë me gjatësi 15 km, sikurse kemi thënë më parë, aktualisht përdoret një qark si linjë 35 kV dhe qarku i dytë si linjë 10 kV.
- Do të garantojë furnizimin me energji elektrike të tunelit i cili në përfaqëson një konsumator të rëndësishëm dhe nga ana tjetër ka një konsum të konsiderueshëm.
- Lejon zhvillimin perspektiv të rrjetit në të ardhmen. Në prespektivë ekziston mundësia që të mbyllet linja 110 kV dhe 35 kV nga N/Stacioni i ri 110/35/20 kV Palasë në N/Stacionin 110/35/20 kV Orikum

#### **ZGJERIMI I SISTEMIT TË LOKALIZATORËVE TË DIFEKTEVE**

Ngritja e një sistemi për lokalizimin e avarive në linjat e transmetimit është i një rëndësie të veçantë.

Lokalizimi i avarisë në mënyrë sa më precise në linjat e transmetimit me anë të digital fault locators dhe pasqyrimi i i avarisë në sallat e monitorimit është një avantazh shumë i madh për të rritur sigurinë e sistemit energjetik.

Vendodhja e gabimit kërkohet në të gjitha qarqet e ndërlidhura. Lokatori i gabimit jep gabimin në saktësi deri në dhjetra metra afër vendodhjes dhe për të gjitha llojet e defektit të pavaruar nga gjatësia e linjës në linjat ajrore duke filluar nga disa metra deri në 50 km.

Lokatori i gabimit vepron në mënyrë të barabartë në:

- Qarku i hapur, faza në tokë dhe faza në fazë
- Linja me ngarkesa të caktuara
- Linja me ndërtime jouniforme
- Linja me kompensim në seri
- Qarqet DC me njësitë e përshtatshme të bashkimit

Saktësia e lokatorit të gabimeve nuk ndikohet nga:

- Gabimet në toke të rezistencës së lartë me infeksione në fund te largët
- Rrymat e gabimeve jo sinusoidale të prodhuara nga arcing
- Zhvillim dhe /ose defekt i paqendrueshëm
- Kapaciteti i shpërndare i linjave të gjata.
- Gabimet e CT dhe VT

Lokatorët e defekteve do të jenë të instaluar në mënyrë të përhershme dhe do të veprojnë në principin e valës së veprimit.

#### **PËRFITIMET:**

- Rrit sigurinë dhe besueshmërinë e sistemit të transmetimit;

## FURNIZIMI II FAZËS REZERVË 400/220 KV 115 MVA KOMAN

Në kuadër të projektit të fuqizimit të N/stacionit të Komanit është montuar dhe në shfrytëzim një nga autotransformatorët më të fuqishëm të OST sh.a.: -AT-3x115 MVA, 410/230 kV.

Por, për këtë pajisje mjaft të rëndësishme, pa mirëfeksionimin e së cilës i gjithë investimi (N/stacioni) është nul, nuk është parashikuar një fazë rezervë, që do të shërbente si zëvendësuese për çdo avari apo problem në njërin nga fazët përbërëse të AT-së dhe do të bënte që AT-3x115 MVA, 410/230 kV (pra edhe N/stacioni) të kthehej në shfrytëzim dhe gjëndje gadishmërie teknike në një kohë mjaft të shpejtë.

Gjithashtu për AT-3x115 MVA, 410/230 kV nuk janë parashikuar pjeset rezervë për mirëmbajtje gjatë shfrytëzimit.

Për sa më sipër janë dhënë propozimet përkatëse në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Njësia	Sasia	Njësia/N/stacioni
1	AT-115 MVA, 410√3/230√3 kV	Komplet	1	NJO Shkodër /Koman
2	Pjesë rezervë për AT-3x115 MVA, 410/230 kV			NJO Shkodër /Koman
2.1	Izolator kalimtar 400 kV	copë	1	-II-
2.2	Izolator kalimtar 220 kV	copë	1	-II-
2.3	Izolator kalimtar për nulin	copë	1	-II-
2.4	Rele gazore (Buchholz relay)	copë	1	-II-
2.5	Rele për OLTC (protection relay for OLTC)	copë	1	-II-
2.6	Rele gazore për kontrollin e diafragmës	copë	1	-II-
2.7	Rele presioni për kazanin kryesor	copë	1	-II-
2.8	Rele presioni për OLTC	copë	1	-II-
2.9	Valvola të cdo tipi dhe madhësie nga një copë	komplet	1	-II-
2.10	Termometër për matjen e temperaturës së vajit	copë	1	-II-
2.11	Termometër për matjen e temperaturës së pështjellës	copë	1	-II-
2.12	Enë dehidratimi të ajrit pa mirëmbajtje për kazanin kryesor	copë	1	-II-
2.13	Enë dehidratimi të ajrit pa mirëmbajtje për OLTC	copë	1	-II-
2.14	Komplet gominash për një fazë të autotransformatorit	komplet	1	-II-

### PËRFITIMET:

- Rrit sigurinë e operimit jo vetëm të Rajonit Verilindor por edhe të sistemit të transmetimit për shkak të fuqisë së konsiderueshme të autotransformatorit të Komanit;

## FURNIZIM DHE VENDOSJE E NJË SHUNT-REAKTORI 400 KV, 120 MVAR, NË NËNSTACIONIN 400,220,110KV TIRANA2

Aktualisht identifikohen vlera të larta të tensionit në nivelin 400 kV. Paralelisht me zhvillimin e rrjetit ka pasur dhe një rritje të ndjeshme të gjenerimeve të reja (gjeneruesit e vogël), shumica prej të cilëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, gjë që ka ndikuar në uljen e ngarkesës në rrjetin e transmetimit. Nga ana tjetër, ngarkimi i nivelit 400 kV është i ulët, rreth 20-30% të kapacitetit të tij, duke gjeneruar fuqi reaktive në rrjet, që sjell detyrimisht nivele të larta tensioni. Për të paraprirë situata të vështira në lidhje me problemet në nivelet e tensionit, parashikojmë vendosjen e një shunt-reaktori, 120 MVAR në nënstacionin Tirana2.


- **PËRFITIMET:** Rrit sigurinë dhe besueshmërinë e sistemit të transmetimit;

## ZGJERIMI DHE RIKONSTRUKSIONI N/ST SHARRË

Nënstacioni Sharrë aktualisht ka të instaluar dy autotransformatorë fuqie AT-1 220/110 kV 100MVA dhe AT-2 220/110/35 kV 90 MVA. Ky nënstacion furnizohet nga linjat 220 kV Tirana2-Sharrë dhe Elbasan2-Sharrë . Nga zbarat 110 kV të këtij nënstacioni dalin dy linja 110 kV, Linja Sharrë –Selitë dhe linja Sharrë Rrashbull. Nga ky nënstacion del dhe linja 35 kV Sharrë –N/st Kombinat (nënstacion i OSHEE).

Ashtu sikundër edhe shikohet nga diagrama e mëposhtme, skema e këtij nënstacioni ka disa të meta dhe mangësi themelore dhe konkretisht:

- Mungojnë traktet 220 kV për të dy linjat 220 kV
- Mungesa në elementet e traktit 110 kV të AT (mungon çelësi 110 kV dhe thika 110 kV)
- Mungesë e shkarkuesve në traktet e linjave 110 kV
- Ka vetëm një seksion nga ana 220 kV
- Ka vetëm një seksion nga ana 110 kV
- Lidhja e të dy autotransformatorëve “kokë më kokë” nga ana 220 kV .



*Skema aktuale njëpolare e nënstacionit Sharrë*

Duke marrë në konsideratë projektet për zhvillimin e rrjetit që janë në fazën e implementimit në rajonin e Tiranës si :

- Zhvillimi i “unazës” të Tiranës, ndërtimin i nënstacionit Tirana 3. Në këtë projekt veç të tjerave është planifikuar edhe ndërtimi i linjës së re 110 kV Tirana3-Selitë (linjë kjo që do të zëvendësojë linjën ekzistuese 110 kV Selitë – Traktora e cila do të demontohet). Ndërtimi i kësaj linje 110 kV pritet të ule ngarkesën nga ana 110 kV në nënstacion Sharrë.

- Implementimi i projektit për ndërtimin e linjës dyfishe 220 kV Tirana2-Rrashbull do përmirësojë në mënyrë të ndjeshme sigurinë e furnizimit në rajonin e Durrësit, dhe ul ngarkesën e anës 110 kV të nënstacionit Sharrë.
- Ndërtimi dhe vënia në operim e nënstacionit 110/20 kV Kombinat (investim i OSHEE) do të përmirësojë furnizimin e rajonit në këtë zonë dhe pritjet të ulë ngarkesën e anës 35 kV të nënstacionit Sharrë.


Pritet që pas përfundimit të këtyre investimeve ngarkesa e nënstacionit Sharrë të reduktohet por gjithsesi roli i këtij nënstacioni nga pikpamja e rezervimit të ngarkesës dhe e sigurisë së furnizimit të konsumatorëve (Rajoni Tiranë-Durrës) do të vazhdojë të jetë i rëndësishëm si për rastet e remonteve ashtu edhe për rastet e difekteve .

Një aspekt tjetër që duhet vënë në dukje është se veç mangësive që ky nënstacion ka në skemën primare me e rëndësishmja është që të dy autotransformatorët e instaluar në këtë nënstacion janë tejet të amortizuar (mbi 50 vjet në operim).

Për sa më sipër propozojmë që ky nënstacion të rikonstruktohet, skema e këtij nënstacioni të zhvillohet , të plotësohet me elementet e nevojshëm dhe të vendosen autotransformatorët të cilët do të demontohen në nënstacion Rrashbull 2 X 220/110/20 kV 100MVA.

Fuqizimi, zhvillimi i këtij nënstacioni sipas standartit që tashmë është në OST (nënstacion me dy pale zbara nga ana 220 dhe 110 kV ) është i vështirë për shkak të hapësirave të limituara. Për këtë arsye është analizuar si mundësi zhvillimi i tij me dy seksione 220 kV dhe me dy seksione 110 kV. Detyruar nga hapësirat e kufizuara dhe pamundësinë e zgjerimit të territorit të nënstacionit realizimi i zhvillimit të skemës është i mundur vetëm nëse përdorim paisje hibride, paisje HGIS. Këto paisje janë të integruara dhe japin mundësinë e plotësimit të skemës me elementet e nevojshëm në një sipërfaqe shumë të reduktuar krahasuar me paisjet klasike .

Skema që propozohet për zhvillimin e këtij nënstacioni është skema tip “H” duke përdorur trakte për linjat 220 kV , trakte për transformatorët nga ana 220 kV dhe 110 kV , trakt seksionimi nga ana 220 kV dhe trakt (ose thikë seksionimi ) seksionimi nga ana 110 kV .



Skema e zhvilluar njëpolare e nënstacionit Sharrë

Zëvendësimi i autotransformatorit ekzistues 220/110 kV 100 MVA me autotransformatorët që demontohen në N/stacionin 220/110 kV Rrashbull është i domosdoshëm për shkak të kohës së gjatë të operimit (mbi 50 vjetet).

Realizimi i këtij investimi rrit sigurinë e furnizimit të nënstacionit 110 kV Selitë dhe nënstacionit 220/110 kV Rrashbull, rrit fleksibilitetin e skemës dhe krijon mundësinë pa krijuar shtrengesa për nxjerrjen në skemë remonti të elementëve të rrjetit në këto rajone .

Përmirëson cilësinë e furnizimit duke përmirësuar profilin e tensioneve (autotransformatorët që do të vendosen në Sharrë janë me rregullator automatik të tensionit në ngarkesë ) dhe në mënyrë të veçantë nga pikëpamja e sigurisë së furnizimit, rezervon furnizimin e nënstacioneve në nivelin 110 kV.

Për realizimin e punimeve për zhvillimin , rikonstruksionin e nënstacionit Sharrë minimalisht do të punohet me dy faze, ku faza e parë konsiston në:

✓ *Faza e parë*

Për të mos çenuar operimin e nënstacionit në fazën e parë rekomandohet të zhvillohet pjesa e pa shfrytëzuar, pra ndërtimi i traktit të linjës 220-13/3, zbarat e seksionit të dytë 220 kV si dhe traktin nga ana 220 kV të autotransformatorit 220/110/20 kV që do të shtohet (përfshirë punimet për bazamentin e AT ) po ashtu mund të punohet për traktin e anës 110 kV të kësaj AT deri në lidhjen me seksionin ekzistues 110 kV.

Për të bërë të mundur punimet e kësaj faze duhet të modifikohet skema e furnizimit të këtij nënstacioni duke e kthyer siç ka qenë para ndërhyrjes, të lidhet në formë “T” në linjën 220 - 13/2 Tirana2-Elbasan2, duke lënë jashtë pune daljen e linjes 220/13/3 në drejtim të Elbasan 2 (të mbyllën harqet tek shtylla ankerore ku është bërë çarja e linjës ) .

Duke qenë se do të punohet në pjesën e lirë të teritorit nevoja për stakime do të jetë minimale (me interval ditor ) gjatë procesit fillestar të modifikimit të skemës dhe në fund të fazës së parë për të bërë lidhjet dhe vënien në tension si nga ana 220 dhe 110 kV. Përfundimi i kësaj faze krijon kushtet për të vijuar me fazën e dytë .

## **NDËRTIMI I LINJËS SË RE 110KV GJIRI I LALZIT- PORTO ROMANO**


Ndërtimi i N/stacionit të Gjirit të Lalzit 110/20kV nga operatori i shpërndarjes OSHEE sh.a dhe në kuadër të bashkëpunimit të dyanshëm, nga ana e OST u ndërtua linja 110kV nënstacioni Sallmone- Gjiri i Lalzit si dhe një shtesë trakti në N/stacionin Sallmone e cila u vu në operim në vitin 2020.

Zona e Gjirit të Lalëzit është një zonë me potenciale të mëdha turistike dhe ndërtimi i infrastrukturës së re energjitike do të nxisë investimet e reja në hoteleri dhe infrastrukturën turistike dhe duke rritur numrin e bizneseve të vogla e të mesme duke gjallëruar ekonominë lokale në drejtim të shtimit të prodhimeve bujqësore, blegtorale etj. Gjithashtu do të shërbejë për rritjen e kapaciteteve të mundshme pritëse për burimet e rinovueshme të energjisë sidomos për impiantet solare etj.

Për vetë rëndësinë që ka operimi i N/stacionit Gjiri i Lalzit është e nevojshme furnizimi i tij me një linjë të dytë për të përmushur kriterin e sigurisë statike N-1dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike.




Parashikohet ndërtimi i një linjë të re 110kV nënstationi Gjiri i Lalzit-P.Romano me gjatësi 20km me përcjellës ACSR-240mm<sup>2</sup>. Realizimi i kësaj linje do të sjellë operimin në unazë të të dy nënstationeve si nënstationi P.Romano dhe nënstationit të Gjiri i Lalzit të cilat aktualisht punojnë të lidhur me linja radiale pa mundësi rezervimi nga një burim i dytë energjie. Gjithashtu MIE ka hapur ankandin për ndërtimin e një parku fotovoltaik në zonën e Spitallës e shpallur si një zonë me potencial të lartë diellor me kapacitet të instaluar 100MW i cili planifikohet të lidhet në anën 110kV të Nstacionit Porto Romano.



*Lidhja e Nënstationeve Gjiri i Lalzit dhe Porto Romano me një linjë të re 110kV*

## ZGJERIMI DHE RIKONSTRUKSIONI N/ST F.KRUJË (FAZA E PARË)

Nënstacioni 110 /6 kV F.Krujë është një nënstacion i ndërtuar rreth viteve 1970. Në këtë nënstacion terminojnë tre linja 110 kV, linja Tirana1-F.Krujë, Laç2- F.Krujë dhe linja 110 kV F.Krujë – Krujë ( linje radiale ). Ka të instaluar dy transformator fuqie 110/6 kV të cilët aktualisht janë 31.5 MVA dhe tjetri po 110/6 kV me fuqi 10 MVA . Ky nënstacion është i pozicionuar në veri të qytetit të F.Krujes në një zone industriale pranë fabrikës së çimentos ku ambienti është i ngarkuar me pluhur. Skema njëpolare e këtij nënstacioni është si në figurën në vijim;



*Skema njëpolare e nënstacionit 110/6kV te Fushë Krujës*

Nga skema shihet se dy linjat 110 kV në drejtim të Tirana1 dhe të Laç 2 janë me thika ndërsa linja në drejtim të Krujës është me trakt të rregullt (kryer para 10 vjetësh). Theksojmë se gjendja e paisjeve primare është tejet e amortizuar, sikurse thamë edhe për shkak të kohës së gjatë të operimit dhe për shkak të ambientit të ndotur .

Prej shume vitesh çelsi seksionues është jashtë funksioni (i shuntuar), edhe elementet e tjerë dhe paisjet komutuese janë tejet të amortizuara .

Sa i përket ngarkesës që ka si nënstacion vlen të theksohet se ka pasur një reduktim vitin e fundit pas ndërhyrjes së OSHEE e cila ka instaluar një nënstacion portabël i cili është lidhur në forme “T” në linjën 110 kV Tirana1-F.Krujë dhe ka të instaluar një transformator 110/20 kV me fuqi 25 MVA. Megjithatë ngarkesa e nënstacionit F.Krujë vijon të jetë relativisht e madhe .

Nënstacioni 110 kV F.Krujë praktikisht furnizohet nga zbara 110 kV e nënstationit 220/110/35/20 kV Tirana1. Nënstacioni Tirana1 nga ana 110 kV (zbarën 110 kV) furnizohet me tre autotransformator 220/110/35 kV me fuqi 120 MVA . Ngarkesa e nënstationit Tirana 1 nga ana 110 kV në muajt e dimrit dhe veçanërisht në orët e pikut në këtë sezon është relativisht shume e madhe . dhe nga pikpamja e fuqisë transformuese është e pa rezervuar .

Nëse gjatë sezonit me ngarkesa të mëdha (sezonit te dimrit) do të dilte nga operimi njeri nga autotransformatorët 220/110/35 kV ashtu siç duket edhe nga grafiku i mësipërm, kjo do të kërkonte reduktim të ngarkesës së këtij nënstationi (kufizime relativisht të mëdha të rendit ~ 40 MW).

Duhet patur parasysh që ngarkesa e zbarës 110 kV e nënstationit Tirana 1 është shumë e vështirë të reduktohet pasi konsumatorët që furnizohen nga kjo zbarë, përjashtojnë nënstationin F.Krujë, kryesisht janë qyteti i Tiranës dhe institucionet të rëndësishme të shtetit.

Duke u nisur nga sa thamë më sipër propozojmë që skema e nënstationi 110/6 kV F.Krujë të zhvillohet, të zgjerohet duke u lidhur në nivelin 220 kV nëpërmjet një autotransformatori 220/110/20 kV .

Zhvillimi i Nënstationit 110/6 kV F.Krujë konsiston në instalimin e një autotransformatori me fuqi 90-120 MVA 220/110/20 kV .

Ky autotransformator nga ana 220 kV do të furnizohet nëpërmjet linjës së re e cila duhet të ndërtohet nga nënstationi 220/6kV Fabrikës Çimentos F.Krujë deri tek Nënstationi 110 /6 kV F.Krujë. Nga ana 110 kV do të lidhet me zbarat ekzistuese të Nënstationit 110/6 kV F.Krujë. Sigurisht për shkak të amortizimit të madh të paisjeve është e nevojshme të bëhet edhe rikonstruksioni i zbarave 110 kV të këtij nënstationi përfshi dhe ndërtimin e dy trakteve të reja 110 kV për linjat F.Krujë –Laç1 dhe F.Krujë –Tirana1.


Nënstationi 220/6kV Fabrikës Çimentos F.Krujë fizikisht është i pozicionuar në një distancë ~250 m nga Nënstationi 110 /6 kV F.Krujë. Ndërtimi I linjës së re 220 kV përfshin edhe ndërtimin e traktit 220 kV në nënstationin 220/6 kV Fabrikës Çimentos.

Sa i përket zhvillimit të anës 220 kV në Nënstation 110/6 kV F.Krujë , duke qenë se hapësirat e nënstationit janë të kufizuara propozojmë që të ndërtohet vetëm trakti i autotransformatorit nga ana 220 kV (pa trakt linje 220 kV ), edhe për faktin se distanca (gjatësia e linjës 220 kV) është e vogël ~250 m .

Linja e re 220 kV F.Çimento – F.Krujë mund të konsiderohet si “zgjatim” i zbarave 220 kV të nënstationit 220/6 kV F.Çimento dhe në këtë sens nuk është I domosdoshëm ndërtimi i traktit 220 kV të kësaj linje në nënstation F.Krujë .

Nga ana 110 kV do të ndërtohet një seksion i ri në zgjatim dhe në aks të seksioneve egzistuese ku do të lidhet nga ana 110 kV me trakt të rregullt autotransformatori 90 MVA 220/110/20 kV.

Seksioni i ri 110 kV do të lidhet me seksionin egzistues vetëm nëpërmjet një ndarësi (thike) 110 kV . Po ashtu do të ketë edhe daljen 20 kV e cila mund të zhvillohet në të ardhmen me ndërtimin e impiantit 20 kV sipas kërkesës dhe nevojës së kompanisë së shpërndarjes OSSHE.



*Skema e zhvilluar e nënstacionit F.Krujës dhe rrjetit të ri 220kV furnizues të tij*

Ashtu sikundër u tha më lartë hapsirat për të zhvilluar skemën janë të kufizuara prandaj traktet e autotransformatorit si nga ana 220 kV dhe ana 110 kV do të jenë me paisje të integruara HGIS, ndërsa rikonstruksioni, ndërtimi i dy trakteve të linjave 110 kV F.Krujë –Laç1 dhe F-Krujë –Tirana1 si dhe seksionuesi 110 kV mund të ndërtohen me paisje klasike pasi kanë hapsirën e nevojshme .

Vendosja e këtij autotransformatori 90-120 MVA 220/110/20 kV në nënstacionin e F.Krujës e rrit shume fleksibilitetin e skemës 110 kV të këtij rajoni pasi krijon mundësinë e injektimit të energjisë në këtë pjesë të rrjetit 110 kV, duke rrezervuar deri ne 60 MW (kapaciteti i linjës 110 kV F.Kruje –Tirana1) për zbarën 110 kV të nënstacionit Tirana1. Po ashtu rezervon furnizimin e një konsumatori të rëndësishëm siç është Fabrika e Çimentos F.Krujë e cila aktualisht furnizohet në mënyrë radiale nga linja 220 kV nga Nënstacioni Antea Çimento –F.Çimento.

Disa nga avantazhet kryesore që sjell ky investim janë:

- Përmirëson cilësinë e furnizimit duke siguruar rrezervim për konsumatorët e rajonit të F. Krujës, Krujes , Laçit dhe konsumatorëve që furnizohen nga zbara 110 kV e nënstacionit Tirana1. Rrezervon furnizimin e Fabrikës së Çimentos.
- Vendosja e një autotransformatori ( nëpërmjet RAT) do të bëjë të mundur dhe rregullimin e profilit të tensioneve në rrjetin 110 kV të këtij rajoni .
- Redukton humbjet në rrjetin 110 kV të këtij rajoni.
- Nëpërmjet rikonstruksionit të trakteve dhe zbarave 110 kV do të rritet siguria e furnizimit të konsumatorëve që furnizohen nga N/st F.Krujë.
- Rritet shumë “fleksibiliteti” i skemës si nga ana 110 kV por edhe nga ana 220 kV për këtë rajon.
- Krijon mundësinë për zhvillimin në prespektivë të rrjetit 20 kV në rajonin e F.Krujës.

## **RIKONSTRUKSIONE NËNSTACIONESH**

Përzgjedhja e këtyre nënstacioneve është bërë duke pasur parasysh masën e amortizimit të paisjeve 110 kV si dhe rëndësinë që kanë në mbylljen e unazave 110 kV të rrjetit në rajonet verilindore, jugore dhe lindore të vendit. Ndërsa Nënstacioni i Pogradecit është futur në listë edhe për shkak të rehabilitimit të këtij nënstacioni nga ana e OSSH proces i cili ka avancuar.

Këto rikonstruksione në pjesën më të madhe të tyre përfshijnë demontimin dhe rikonstruksionin e impianteve 110kV, nëpërmjet rikonstruksionit të zbarave 110kV, seksionuesit të zbarrave, trakteve 110kV të linjave nëpërmjet rehabilitimit të anës primare dhe sekondare të tyre.

## **BLERJA E NJË TRAKTI LËVIZËS 110KV**

Nevoja për blerjen e një trakti portativ 110 kV vjen si rezultat i gjendjes tejte të amortizuar të të gjithë impianteve 110 kV që janë transferuar në OST në OSHEE-ja. Shpesh herë riparimet e pajisjeve primare janë procese që kërkojnë kohë dhe materiale specifike dhe në raste të veçanta shkakton vonesa dhe ndërprerje të tejkzgatura të furnizimit të konsumatorëve (dëmtimet në çelësa, Tr. rryme, thika etj.).

Gjithashtu, në procesin e implementimit të projekteve që lidhen me rikonstruksionet e nënstacioneve 110 kV do të ishte një avantazh i madh për të bërë modifikimet e skemës për periudhat provizore gjatë implementimit të këtyre rikonstruksioneve. Për këto arsye propozojmë të planifikohet blerja e një trakti portativ 110 kV.

## **NDËRTIM I LINJËS SË RE ÇOROVODË - KËLCYRË, 30 KM.**

Nënstacioni i Çorovodës është një nënstacion i ndërtuar së fundmi me një linjë të re 110, me përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup>, që lidhet me nënstacionin ekzistues të Uznovës. Ky nënstacion është fundor dhe në këtë zonë ka mjaft burime gjeneruese të lidhur në rrjetin e shpërndarjes (rreth 23 MW) dhe të tjerë që parashikohet të lidhen në zonë.

Ndërtimi i kësaj linje bëhet i nevojshëm për plotësimin e kriterit të sigurisë N-1 në këtë zonë, mbasi nënstacioni i Çorovodës është fundor dhe në këtë zonë ka mjaft burime gjeneruese të lidhur në rrjetin e shpërndarjes (rreth 23 MW) dhe të tjerë që parashikohet të lidhen në zonë.

Ndërtimi i kësaj linje krijon një rrjet unazor të ri, që bën të mundur plotësimin e kriterit të sigurisë N-1.

Linja e re do të jetë me një qark, me përcjellës ACSR240/40 mm<sup>2</sup>, me gjatësi rreth 30 km dhe në këtë projekt është parashikuar gjithashtu shtimi i një trakti në nënstacionin Corovode, Kelcyre dhe punime sistemi në nënstacionin 110 kV Kelcyre.




Diagrama njëfazore e linjës së re 110kV Çorovodë-Këlcyrë.

## NDËRTIMI I LINJËS SË RE 110KV HEC LURË- SHUMAT

Rrjeti elektrik në segmentet Fierzë – Fushë Arrëz – Kukës – Lapaj – Peshkopi – Bulqizë – Burrel përfaqëson një unazë 110 kV me një shtrirje në të gjithë zonën verilindore të vendit, në të cilën janë lidhur dhe janë në proces ndërtimi një numër i madh HEC-esh me fuqi të përgjithshme 281 MW.


Për të rritur kapacitetin transmetues, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike të zonës nga ana e OST janë në proces zbatimi projektet :

- Ndërtimi i linjës së re 220 kV Burrel – Peshkopi dhe trakti dalës në Nstacionin e Burrelit.
- Ndërtimit të nënstacionit të ri 220/110/35 kV Shumat, dhe i traktit 220kV në Nëstacionin e Burrelit.


Të dy investimet priten të sjellin një impakt të madh në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe përmirësimin e profilit të tensionit. Vënia në shfrytëzim e këtyre projekteve do të garantojë operimin optimal të burimeve hidrike të zonës dhe një furnizim cilësor për konsumatorët.

Në kuadër të fuqizimit të unazës verilindore dhe paralelisht me ndërtimin e nëstacionit 220/110/35kV planifikohet realizimi i një linje 110kV me dy qarqe me gjatësi 23km e cila do të shërbejë për lidhjen e nënstacioneve të HEC Lurës dhe të anës 110kV të Nstacionit të Shumatit.

Aktualisht nënstacioni i HEC Lurës operon në mënyrë radiale dhe i lidhur me sistemin vetëm me linjën 110kV L-110-46 e cila përfundon në nëstacionin e Kurbneshit i cili nga ana e tij është i lidhur me sistemin me anë të linjës 110kV L-110-3 e cila përfundon në anën 110kV të HEC Ulëz siç paraqitet në figurën e mëposhtme:



Skema e lidhjes së Nënstacioneve Kurbnesh dhe Shutri si dhe gjeneruesit e lidhur në këtë skemë



Linja e re 110kV Nstacioni HEC Lure- Shumat

Pra në këtë skemë janë të lidhur nënstationet Kurbnesh dhe Shutri si dhe gjeneruesit me fuqi totale 37 MW.

Furnizimi i nënstationeve nëpërmjet një linje radiale nënkupton se për këtë nënstation (apo nënstatione) nuk plotësohet kriteri N-1 i sigurisë statike që do të thotë se difektimi i linjës L-110-3 në dalje të nënstationit të HEC Ulzës do të linte pa furnizim nënstationet Kurbnesh dhe Shutri si dhe pa mundësi injektimi në rrjet të gjeneruesve të lidhur në skemë duke sjellë penalizime për Operatorin e OST në të ardhmen në kuadër të rregullores së cilësisë.

## RIKONSTRUKSION I LINJËS FIER-KAFARAJ-VLORA1


Rajoni midis Fierit dhe zonës së Vlorës është një zonë fushore me potencial të madh të energjisë diellore, dhe ku ka një numër të madh aplikimesh për burime të reja të këtij lloji. Konkretisht është iniciuar një proces nga Ministria e Infrastrukturs dhe Energjise, për ndërtimin e një parku fotovoltaik me fuqi të instaluar prej 50÷140 MW.

Kjo është një linjë e ndërtuar në vitin 1966 me përcjellës AC-95 mm<sup>2</sup> dhe AC-120 mm<sup>2</sup> dhe me kapacitet të kufizuar të transmetimit të energjisë elektrike.

Në kushtet aktuale nuk është e mundur plotësimi i kriterit të sigurisë N-1, në rast stakimi të ekstremiteve të linjës 110 kV. Rikonstruksioni i kësaj linje tashmë është bërë i domosdoshëm pavarësisht nga burimet e reja që mund të lidhen në të.

Kjo e bën të domosdoshme fuqizimin e linjës nëpërmjet ndërtimit të një linje te re me një përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup>, rreth 28 km e gjatë.

Në figurën më poshtë jepet paraqitja skematike e ndërtimit të kësaj linje.



*Diagrama njëfazore e linjës Fier- Kafaraj – Vlorë1 që do të rikonstruktohet*



## **UPGRADE HARDWARE-SOFTWARE I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË NËNSTACIONIT 220 KV TIRANA 1.**

Duke marrë shkas nga problematikat e shfaqura gjatë viteve të kaluara në sistemin e kontrollit të nenstacionit 220 kV Tirana 1 është e domosdoshme të bëhet një Upgrade i plotë ( hardware-software) i sistemit në këtë nenstacion. Sistemi aktual ka kaluar një periudhe 10 vjecare të perdorimit dhe sipas standarteve të aplikuara në nenstacionet elektrike është e domosdoshme Upgrade-imi ose zevendesimi i tyre pas një periudhe 10 vjecare. Sistemi aktual permban versione shumë të vjetra të Windows-it, përkatësisht Windows XP SP2 (version i vitit 2001). Për këto sisteme Windows kompania Microsoft ka mbyllur cdo lloj update dhe supporti duke bërë që sistemet e këtij versioni të mos jenë më të përditësuara me patch-et e fundit dhe rrjedhimisht duke ulur ndjeshëm sigurinë në këto sisteme.

Konsumimi i larte i paisjeve hardware te ketij sistemi behet shpesh shkak per nderprerje te monitorimit nga operatoret e nenstacionit si dhe nga dispecerat qendrore te OST sh.a.

Nenstacioni 220 kV Tirana per nga rendesia dhe veprimet operative konsiderohet me i rendesishmei per rajonin e Tiranës dhe rinovimi i sistemit te kontroll-monitorimit konsiderohet me prioritete maksimal. Keto sisteme nuk permbushin as kriteret minimale per sigurine e sistemeve lokale kontroll-monitoruese ( Cyber Security).

## **UPGRADE HARDWARE-SOFTWARE I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË NËNSTACIONIT 220 KV BABICE.**

Duke marrë shkas nga problematikat e shumta të shfaqura gjatë viteve të kaluara në sistemin e kontrollit të nenstacionit 220 kV Babice është e domosdoshme të bëhet një Upgrade i plotë ( hardware-software) i sistemit të kontrollit të ketij nenstacioni. Sistemi aktual nuk jep garanci për operim normal nga ana e dispecerave lokale për këto arsye:

- Konsumimi i larte i paisjeve hardware qe perbejne këto sisteme per shkak te periudhes rreth 15 vjecare te instalimit te tij.
- Fakti qe ekziston vetem 1 paisje Server e cila mban gjithë sistemin dhe në rast dëmtimi nuk ka server të dytë në gjëndje gadishmërie.
- Nuk prodhohen me pjesë këmbimi për paisjet integrale të këtij sistemi Kontroll-Monitorimi sic janë ( Switche Optike, Karta LON për server, Karta Profibus për server). Nuk prodhohen më as versione të softeve të instaluar në server.
- Pjesa e matjeve nuk monitorohet në sistem duke bërë që operatori të marrë ato manualisht rele për rele në panele.
- Versione shumë të vjetra të Windows-it, përkatësisht Windows XP SP2 (version i vitit 2001). Për këto sisteme Windows kompania Microsoft ka mbyllur cdo lloj update dhe supporti. Duhet domosdoshmerisht të kalohet në versionet më të fundit të Windows.
- Versioni i Software SCADA duhet ngritur në përputhje me versionet e reja të Windows për të qënë kompatibel dhe mundësuar operim dhe mirëmbajtje normale të këtij sistemi kontroll-monitorues.
- Serveri i sistemit është shumë i ngarkuar me procese pune dhe rendimenti është zvogëluar ndjeshëm duke cuar në vonesa të shfaqjes së të dhënave në monitorët

e operimit apo ne kryerjen me vonese te procesit te komandimit lokal nga nënstacioni apo të komandimit në distancë nga Dispeceria Qëndrore.

- Për normalizimin e këtij sistemi kontrolli është e domosdoshme të bëhet upgrade i plotë si për punimin normal nga ana e operatorëve lokale ashtu edhe për zgjerimin me trakte të reja të këtij nënstacioni në të ardhmen.
- Këto sisteme nuk përmbushin as kriteret minimale për sigurinë e sistemeve lokale kontroll-monitoruese ( Cyber Security).

### **UPGRADE HARDWARE-SOFTWARE I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË NËNSTACIONIT 220 KV ELBASAN 1.**

Ky nënstacion ashtu si nënstacioni 220 kV Tirana 1 9 janë ndertuar ne te njejtin vit) per nga problematikat e shfaqura gjatë viteve të fundit në sistemin e kontrollit të nënstacionit 220 kV Elbasan 1 është e domosdoshme të bëhet një Upgrade i plotë ( hardware-software) i sistemit në këtë nënstacion. Sistemi aktual ka kaluar një periudhe mbi 10 vjecare të perdorimit dhe sipas standarteve të aplikuara në nënstacionet elektrike rekomandohet Upgrade-imi ose zevendesimi i tyre pas një periudhe 10 vjecare eshte e domosdoshme.

Sistemi aktual permban versione shumë të vjetra të Windows-it, përkatësisht Windows XP SP2 (version i vitit 2001). Për këto sisteme Windows kompania Microsoft ka mbyllur cdo lloj update dhe supporti duke bërë që sistemet e këtij versioni të mos jenë më të përditësuara me patch-et e fundit dhe rrjedhimisht duke ulur ndjeshem sigurinë në kete sistem.

Konsumimi i larte i paisjeve hardware te ketij sistemi behet shpesh shkak per nderprerje te monitorimit nga operatoret e nënstacionit si dhe nga dispecerat qendrore te OST sh.a.

Keto sisteme nuk permbushin as kriteret minimale per sigurine e sistemeve lokale kontroll-monitoruese ( Cyber Security).

### **UPGRADE HARDWARE-SOFTWARE I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË NËNSTACIONIT 220 KV BURREL.**

Sistemi aktual i kontroll-monitorimit ne Burrel ka nje periudhe 10 vjecare implementimi. Sistemi aktual nuk jep garanci per operim normal kryesisht nga konsumimi i larte i paisjeve hardware dhe software i vjeter. Sistemet aktuale janë në versione shumë të vjetra të Windows-it, përkatësisht Windows XP SP2 dhe versione shume te vjetra te kompanise qe ka prodhuar sistemin e kontroll-monitorimit. Ndaj nuk ka me asnje lloj update dhe supporti duke bërë që sistemet e këtij versioni të mos jenë më të përditësuara dhe rrjedhimisht duke ulur ndjeshem sigurinë në keto sisteme.

Keto sisteme nuk permbushin as kriteret minimale per sigurine e sistemeve lokale kontroll-monitoruese ( Cyber Security).

### **UPGRADE HARDWARE-SOFTWARE I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË NËNSTACIONIT 220 KV KOPLIK SI DHE RELEVE TË MBROJTJES/KONTROLLIT.**

Mosrealizimi i kontrates se “Upgrade i sistemit te kontrollit dhe releve te nënstacionit 220 kV KOPLIK” – gjate vitit 2020 le te pazgjidhur problematiken e sistemit aktual lokal te kontrollit ne Koplik. Paisjet Hardware te ketij sistemi vazhdojne te perkeqesohen

Duke qene se gjate viteve 2019 -2021 ka qene nje nder sistemet qe ka shfaqur problematikat me te medha eshte e domosdoshme te behet nje Upgrade i plote ( hardware-software) i sistemit te nenstacionit Kopluk 220 kV si dhe releve te mbrojtjes dhe kontrollit te ketij nenstacioni . Sistemi aktual nuk jep garanci per operim normal kryesisht nga konsumimi i larte i paisjeve hardware qe perbejne kete sistem per shkak se ka mbi 10 vjet nga periudha e instalimit. Gjithashtu ne kete sistem nuk funksionon redundanca ndermjet dy serverave dhe komunikimi me rrelete eshte shume i vjeter me protokoll komunikimi LON i cili jep shkeputje te shpeshta te marrjes se te dhenave nga relete e kontrollit drejt sistemi lokal te kontroll-monitorimit. Kjo con ne mungese informacioni per operatorin lokal gjithashtu edhe ne mungese informacioni per Dispecerin Qendror.

Nenstacioni i Koplikut eshte i rendesishem pasi ka dhe nje linje interkonjeksioni me Malin e Zi dhe vlera e shkembimit te energjise nga kjo linje eshte e domosdoshme per vendosjen ne pune te LFC-se ne sistemin SCADA/EMS. Shkeputjet e shpeshta te komunikimit te sistemit lokal me sistemin qendror pengojne operimin normal te LFC-se prandaj konsiderohet shume e rendesishme upgrde-i i ketij sistemi.

Keto sisteme nuk permbushin as kriteret minimale per sigurine e sistemeve lokale kontroll-monitoruese (Cyber Security).

### **SISTEMI PËR PERPUNIMIN E TË DHËNAVE TË MATJES**

OST sh.a. disponon disa sisteme te teknologjise se informacionit, nga te cilat perftohen te dhena si energjia aktive, energjia reaktive, tensioni, frekuenca, skedulet e energjise per cdo pjesemarres tregu, programi kompensimit, skeduli interkoneksionit etj. Keto te dhena perftohen nga sistemi i matjes online dhe sistemi DAMAS. Volumi i te dhenave eshte mjaft i madh dhe perpunimi i tyre deri me tani realizohet ne softin Excel te paketes Microsoft. Perpunimi i te dhenave me softin krijon nje veshtiresi te madhe dhe njekohesisht eshte burim i gabimit ne perpunimin tyre. Rredhimisht per te rritur cilesine e perpunimit te dhenave dhe lehtesuar punen e specialisteve te sektorit te planifikimit te operimit, eshte e nevojshme te sigurohet nje sistem IT i cili te nderfaqesoje me sistemet ekzistuese.

Sistemi i ri i perpunimit te te dhenave dhe raportimit duhet kete keto kaakteristika kryesore:

- Ndërfaqësimin me Sistemin e Matjes të Energjise (SME) dhe Sistemin Damas (SD)
- Përfitim të të dhënave që disponojnë SME dhe SD në mënyre automatike dhe në forme manuale (opsionale);
- Mundësinë e përpunimit të të dhënave me funksione/operatore algjebrike etj;
- Raportim të dhënash në ndërfaqe grafike dhe funksione eksporti të dhënave në formate të ndryshme.

Kostot kapitale të OST sh.a. sipas metodologjisë për vitin 2021 duhet të mbulojnë:

- Detyrimet e vitit 2021 të principalit dhe interesit për fondet e huazuara sipas skeduleve të ripagesës së huave afatgjata.
- Investimet me fondet që OST sh.a. gjeneron nga aktiviteti të përfshira në Programin e Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2021.

$$C_{\text{kapital}} = R + D$$

**R** Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve

**D** Amortizimi i aseteve fikse dhe amortizimi i aseteve të tjera

$$R = B * WACC$$

**B** Aseti Bazë i Rregulluar në fillim të vitit bazë të ciklit të vlerësimit të tarifave

**WACC** Norma e lejueshme e kthimit të Asetit Bazë të Rregulluar.

Llogaritja e Asetit Bazë të Rregulluar (**B**) në fillim të vitit bazë 2022 (Vlera në fund të vitit 2021) është kryer duke llogaritur kapitalizimin e të gjitha investimeve në proces deri në 31.12.2021.

Për vitin 2022 amortizimi i parashikuar pritet të jetë rreth 2,696 milione lekë ndërsa Aseti Bazë i Rregulluar (RAB) në fillim të vitit 2022 është rreth 50,181 milion lekë.

Rezultatet e perlllogaritjeve për vitet 2022-2024, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Viti	RAB në fillim të periudhës	Investimet	Amortizimi	RAB në fund të periudhës
2021	48,016	4,685	2,520	50,181
2022	50,181	6,918	2,696	54,403
2023	54,403	5,301	2,800	56,904
2024	56,904	4,343	2,862	58,386

Sipas metodologjisë norma e lejueshme e kthimit për Asetin Bazë të Rregulluar është:

Norma e lejuar e kthimit mbi Asetin Bazë të Rregulluar është mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit para taksave, e llogaritur si vijon:

$$WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1$$

Ku:

**ES** Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB

**T** Norma e taksës së korporatës (Tatim-fitimi)

**ARoE** Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse

**DS** Objektivi për raportin e borxhit në RAB

**CoD** Kosto e borxhit

**ARoE** - Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazen e nevojës së OST-se për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve në vitin bazë.

**CoD** - Kosto e borxhit – norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë është përcaktuar si shuma e pagesave të interesit mbi borxhin afatgjatë gjatë vitit baze, pjesëtuar me principalin total mbi borxhin afatgjatë (shuma totale e marrë borxh) në fillim të vitit bazë.

Struktura e kapitalit afatgjatë të OST sh.a. sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2021 përbëhet nga kapitali i vet 63.4% dhe borxhi afatgjatë në masën 36.6%.

Për vitet 2022-2024, objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB është llogaritur: **ES=61.1% për 2022; ES=59.5% për 2023; ES=60.24% për 2024;**

Për vitet 2022-2024, OST sh.a. ka përdorur një normë minimale të kthimit **Aroe = 4%** ne menyre qe te mbuloje realizimin e investimeve te domosdoshme.

Interesat e perlllogaritura për vitin 2022 janë në vlerën 664 milionë lekë norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë është llogaritur: **CoD=3.72%**; Për vitin 2023 **CoD=2.55%**; Për vitin 2024 **CoD=2.28%**.

Gjëndja e Huawei Afatgjata të OST sh.a., deri në fund të muajit Qershor 2021, gjendet aneks më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

Pjesa e prapambetur e detyrimeve për kredi afatgjata, deri ne fund te muajit Qershor 2021, pa përfshirë penalitetet, është 10,586 milionë lekë, nga te cilat 6,232 milionë lekë janë detyrime ndaj MFE dhe 4,354 ndaj KESH sh.a. Detyrimi për pagesën e këtyre kredive të prapambetura është e OSHEE sipas vendimit të ERE nr. 190, datë 22.12.2016.

Sipas metodologjisë:

- *Financimi afatgjatë i borxhit duhet përdorur për të financuar shpenzimet e reja kapitale për aq sa është e mundur, por nuk duhet përdorur për të mbuluar kostot e operimit*

OST i përdor fondet e siguruara nga kreditë afatgjatë ekskluzivisht për investimet e reja kapitale.

Gjatë viteve të fundit OST është angazhuar kredi afatgjata për të financuar projekte madhore për zgjerimin dhe përmirësimin sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Kjo gjë ka rritur detyrimet për interes dhe principal që duhen shlyer gjatë vitit 2022 të cilat janë rreth 2,530 milion lekë.

## B. Kostot operuese

$$C_{\text{operuese}} = C_{\text{matjes}} + C_{\text{mirëmbajtje}} + C_{\text{paga}} + C_{\text{humbjet}} + C_{\text{shërbimeve ndihmëse}} + C_{\text{shërbime me të trete}} + C_{\text{takse}}$$

**C<sub>matjes</sub>** kosto e matjes së energjisë elektrike dhe energjisë se livruar tek klientët e sistemit të transmetimit dhe kosto e faturimit dhe likuidimeve të llogarive me përdoruesit e sistemit të transmetimit

Këto kosto lidhen me kostot e shkaktuara nga klientët, por nuk përfshin koston e matjes së humbjeve të energjisë elektrike, konsumin e energjisë elektrike për qëllime teknologjike dhe eksportin, importin dhe fluksin e tranzitit. Kostot e matjes janë të përfshira në kostot e tjera operuese të OST sh.a., respektivisht në kostot e pagave dhe mirëmbajtjes

**C<sub>mirëmbajtje</sub>** pjesë zëvendësimi, furnizime, mjete, lëndë djegëse dhe kosto të tjera mirëmbajtje;

**C<sub>paga</sub>** pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe kostot (Të ndryshme nga taksat) të lidhura me programet në përfitim të të punësuarve;

**C<sub>humbjet</sub>** kostot për mbulimin dhe prokurimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Në llogaritjen e tarifës së transmetimit, kosto për humbjet janë llogaritur duke u bazuar në çmimet e tregut:

$$C_{\text{humbje}} = E_{\text{humbje}} * P h$$

**E<sub>humbje</sub>** humbjet e energjisë në rrjetin e transmetimit gjatë vitit bazë

**Ph** çmimi mesatar i energjisë elektrike që do të blihet në treg për mbulimin e humbjeve gjatë vitit bazë.

**C<sub>shërb. Ndhmëse</sub>** pagesa për blerjen e shërbimeve ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit.

**C<sub>takse</sub>** Komponenti që mundëson që rregullatori të tregojë qartë pjesën e tarifës që atribuohet taksave dhe prandaj është përtej kontrollit të rregullatorit. Komponenti takse të ardhurave të synuara të OST-se për vitin baze, nuk përfshin TVSH-ne dhe tatimin mbi fitimin.

Per periudhën 2022-2024, kostot operative të parashikuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Njësia	2021	2022	2023	2024
Personeli	Mln ALL	1,362	1,389	1,417	1,445
Sherbime administrative e te tjera	'''	538	733	711	715
Materiale të para	'''	118	132	134	136
Menaxhimi i kongjestionit me ridispecim	'''	-	521	558	595
Blerja e sherbimeve ndihmese	'''	846	1,708	1,924	2,050
Blerja e humbjeve	'''	1,611	1,400	1,432	1,600
Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	'''	297	250	250	250
<b>TOTALI i Kostove Operative</b>	<b>Mln ALL</b>	<b>4,772</b>	<b>6,133</b>	<b>6,426</b>	<b>6,757</b>

Në mënyrë të detajuar, kostot operative të parashikuara për vitin 2022, po i paraqesim si mëposhte:

✓ **Shpenzimet e Personelit**

Shpenzimet e personelit janë parashikuar duke konsideruar historikun dhe ecurinë aktuale të zërave të kostove të personelit, në përputhje të plotë me strukturën organizative të OST sh.a.. Në përputhje me strukturën aktuale të OST sh.a., për vitin 2022, numri i punonjësve të OST sh.a. është 798 persona dhe shpenzimet totale për personelin janë parashikuar 1,389 milion leke.

<b>Shpenzimet e Personelit</b>		
Fondi i pagave	mln ALL	805
Pagesa për turne dhe orë jashtë orarit	"	56
Shpenzime ushqimi për punonjësit	"	86
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	"	48
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	"	158
Shpenzime page për vjetërsi në punë	"	87
Fondi suplementar i pensionit	"	35
Shpenzime te tjera Personeli	"	44
Paga 13	"	70
<b>Totali</b>	<b>mln ALL</b>	<b>1,389</b>
<b>Nr. mesatar i punonjësve</b>	<b>Nr</b>	<b>798</b>
<b>Paga mesatare</b>	<b>ALL</b>	<b>84,064</b>

Per vitet 2023 dhe 2024, kostot e personelit jane parashikuar duke u indeksuar me nje rritje rreth 2% ne vit.

✓ **Sherbimet administrative e te tjera**

Në këtë zë përfshihen Shërbimet me fondet e veta për vitin 2022 si dhe shpenzimet periodike që OST sh.a. kryen për funksionimin e saj (si psh: mirëmbajtja e platformave dhe sistemeve të ndryshme të operimit, mirëmbajtja e godinave, mirëmbajtja e automjeteve, ruajtja e objekteve, shpenzimet e kryera nga të tretë për shërbime dhe mirembajtje, ujë, siguracione, pagesat e ERE etj). Për vitin 2022, janë parashikuar rreth 644 milione leke per keto sherbime te domosdoshme per OST sh.a.. Në mënyrë më të detajuar, paraqiten si më poshtë:

Nr	Sherbime administrative e te tjera	Leke
1	Organizma Rajonale	105,000,000
2	Mirembajtje platforma dhe sisteme SOFTWARE	102,375,000
3	Ruajtje Objekte	98,000,000
4	Vlerësim i Përgjithshëm mbi Sigurinë Kibernetike dhe kryerje e Testimeve mbi Infrastrukturën dhe platformave Teknologjike	50,000,000
5	Mirembajtja e automjeteve	30,000,000
6	Automjete me qira operationale "Leasing"	30,000,000
7	Studim, Hartimi i Planit të Mbrojtjes se Sistemit të OST sh.a.	40,000,000
8	Studim per qarkullimin e fuqise reaktive dhe permiresimin e nivelit te tensionit ne rrjetin 110kV	40,000,000
9	Kërkime dhe studime	28,000,000
10	Trainime per punonjesit	20,000,000
11	Shpenzime për konçesione, patenta, liçensa dhe të ngjashme	20,000,000
12	Mirembajtja e godines dhe sistemeve te saj	20,000,000
13	Mirembajtje e ambjenteve te jashtme te zyrave qendrore	17,000,000
14	Eksperte Kontabel dhe Vleresues	20,000,000
15	Shpenzime postare dhe telekomunikimi	16,000,000
16	Bileta për transport ajror.	15,000,000
17	Lyerje shtyllash (Blerje boje)	10,000,000
18	Sherbim Teknik me jashte, aplikime, pjesmarrje	10,000,000
19	ERE	24,000,000
20	Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	5,000,000
21	Kompesimi i disbalancave në raste avarie ne rrjet	8,500,000
22	Sherbim linje telekomunikacioni NDC HTSO-NDC OST, per nje vit	3,000,000
23	Keshilli Mbikqyres	2,500,000
24	Shpenzime për shërbimet bankare	2,500,000
25	Sigurime	2,400,000
26	Publicitet, reklama	1,400,000
27	Te tjera	12,000,000
<b>TOTAL</b>		<b>732,675,000</b>

Per vitet 2023 dhe 2024, këto shpenzime jane parashikuar të jenë përkatësisht 711 milionë leke dhe 715 milionë lekë.



✓ **Menaxhimi i kongestionit me ridispecim**

Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për dispeçimin e energjisë elektrike nga centralet prodhuese në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike. Për të ciluar konxhestionin në rrjet, në rastët kur shfaqet, aplikohet ridispecimi, që nënkupton uljen e gjenerimit në një pikë të caktuar të injektimit në rrjet, dhe rritjen respektive të gjenerimit në një pikë tjetër të injektimit në rrjet, ose sipas rastit vetëm uljen apo rritjen e gjenerimit në funksion të kongestionit të krijuar. Ky ndryshim i gjenerimit, krahasuar me programin e kontraktuar që ka deklaruar pjesmarrësi përkatës në treg, duhet të kompensohet nga OST, si në rastin e uljes, ashtu edhe në rastin e rritjes së gjenerimit, për një periudhë të caktuar kohore që vlerësohet nga Operatori.

Te gjitha masat e përmendura më sipër duhet të përcaktohen dhe futen në veprim sipas një plani të mirë studiuar sepse në të kundërt do të shoqëroheshin me kosto të lartë financiare për OST deri në kolapsin dhe rënien e sistemit. Si rrjedhojë studimi, hartim i planit të mbrojtjes së sistemit të OST gjykohet si i domosdoshem për OST sh.a.

### - **Studim për qarkullimin e fuqisë reaktive dhe përmirësimin e nivelit të tensionit në rrjetin 110 kV,**

Ne vitet e fundit Operatori i Sistemit të Transmetimit, është perballur në aspektin e operimit me sfida të reja, kryesisht nxitur nga ligji Nr.43/2015 “Per Sektorin e Energjise elektrike”, Ligji Nr.7 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Rrjeti Transmetimit dhe politikat lehtësuese të sektorit për akses në Rrjetin e Transmetimit, në linje me ligjin Nr.43/2015, kanë sjelle një rritje të burimeve hidrogjeneruese të lidhura me Rrjetin e Transmetimit dhe të Shpërndarjes. Në disa zona të rrjetit të transmetimit, vihet re një profil i lartë i tensionit, pranë limitit të lejuar nga Kodi i Transmetimit. Në këtë kuader është i nevojshëm një studim për nivelin e tensionit në rrjetin 110 kV. Studimi paraqet interes për OST sh.a. por edhe për “palet e interesit”, pasi do të jete një studim i cili do të ketë në fokus:

1. Studimin e problematikave në planin operimit për gjendjen aktuale të Rrjetit të Transmetimit dhe vecanerisht për skenare tipike me ngarkesë të ulët.
2. Studimin e nivelit të tensionit në rrjetin 110kV, dhe identifikimi i mundësive për optimizimin dhe kompensimin e fuqisë reaktive nepermjet përdorimit të teknologjive “smart” si SVC, TCR, STATCOM.

- Rishikimi dhe amendime ne legjislacionin sekondar (Kodi i Rrjetit te Transmetimit etj) per sherbimet ndihmese, e harmonizuar me zhvillimet dhe njesite e reja hidrogjeneruese te lidhura ne Rrjetin e Transmetimit (te mesme, te vogla).

Perfitime te OST sh.a. pas finalizimit te studimit do te jene:

- Pergatitjen e Rrjetit te Transmetimit per integrimin e burimeve te reja te rinovueshme fotovoltaike, me ere, biomase, hidro etj.
- Masa konkrete per zgjidhjen e problemeve te operimit te shfaqura ne rrjetin e transmetimit, si niveli i larte i tensionit, ne 400 kV ose 110 kV ne zonat me shume burime te rinovueshme te vogla hidrogjeneruese dhe me konsum te ulet, si dhe menaxhimi kongjestioneve te brendshme tashme te njohura kryesisht ne Rajonin Verilindor.
- Reduktimin e humbjeve teknike ne Rrjetin e Transmetimit
- Permiresimi nivelit te tensionit pas konkretizimit te propozimeve nga studimi, ne Rrjetin e OST, te cilat rrjedhimisht do te ulin ndjeshem avarite ne Rrjetin e Transmetimit, duke garantuar ne kete menyre nje cilesi dhe siguri te furnizimit me energji elektrike per te gjithë perdoruesit ne Rrjetin e Transmetimit (OSHEE, Konsumator Industrial etj.).

Duke marre shkas dhe nga kerkesat e perseritura te OSHEE problematikat e nivelit te tensionit, ne gjykimin tone mendojme se studimi “Studim për qarkullimin e fuqisë reaktive dhe përmirësimin e nivelit të tensionit në rrjetin 110kV” do te adresoje keto problematika duke propozuar dhe zgjidhje te mundshme per permiresimin e nivelit te tensionit ne rajonin verilindor.

Qëllimet e kërkimeve dhe studimeve janë të lidhura me shërbimet e sistemit të transmetimit, për realizimin e investimeve të nevojshme për fuqizimin dhe modernizimin e tij. OST kryen studime të vazhdueshme si për zona të veçanta të rrjetit të transmetimit ashtu edhe të lidhjes së sistemit elektroenergjetik Shqiptar me sistemet e vendeve fqinje për të realizuar.

Planifikimin e zhvillimit të rrjetit të transmetimit,  
Rehabilitimin dhe Fuqizimin e rrjetit të transmetimit,  
Krijimin e nyjeve të reja lidhëse,  
Përmirësimin e procesit të menaxhimit, kontrollit, matjes etj., sepse

OST merr në konsideratë dhe ndjek zhvillimin kombëtar dhe rajonal në përputhshmëri të plotë me direktivat e ENTSO-E.

Përsa i takon zërit “kërkime studime”, referuar realizimit faktik për periudhën Janar – Dhjetor 2020 si dhe Janar-Shtator 2021, në tabelën e mëposhtme tregohen detajimet e këtij zëri:

### Studime dhe kerkime 2020

Pershkrim	Viti 2020
Raporte vleresimi lidhur me ndikimet ne mjedis para ndertimit te linjave	525,000.00
Studim i te dhenave te gjeneratoreve ne kaskaden e Drinit	98,000.00
Instituti Ndertimit, oponente teknike per ndertimet e linjave	1,562,689.15
Perditesimi i moduleve , topologjise dhe analizave per aplikacionet e rrjetit EMS	2,552,000.00
Raport vleresimi i pergjithshem mbi sigurine kibernetike dhe kryerje e testimeve mbi infrastrukturen dhe platformave teknologjike	19,999,999.51
Feasibility study on substation modernization measures and SCADA / EMS	3,483,539.15
Plani mbi investimin dhe zhvillimin e rrjetit te transmetimit-master plan	20,011,464.82
Hartime projektesh per rehabilitimin ose ndertimin e n/st	15,037,342.00
<b>TOTALI</b>	<b>63,270,034.63</b>

## Studime dhe kerkime 2021

Pershkrim	Janar-Shtator 2021
Instituti Ndertimit, oponente teknike per ndertimet e linjave	1,723,018.34
Raporte vleresimi lidhur me ndikimet ne mjedis para ndertimit te linjave	1,928,653.33
Raport vleresimi i pergjithshem mbi sigurine kibernetike dhe kryerje e testimave mbi infrastrukturen dhe platformave teknologjike	78,900,000.00
Plani mbi investimin dhe zhvillimin e rrjetit te transmetimit-master plan	28,314,634.06
<b>TOTALI</b>	<b>110,866,305.73</b>

Ndërkohë, në lidhje me kërkuesin tuaj për dy studimet e parashikuara për tu realizuar nga ana e OST sh.a., sqarojmë që në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit si dhe në përputhje me normat dhe rregullat e përcaktuara për regjistrimet kontabël, realizimi i studimeve të tilla regjistrohet si shpenzim, përveç rasteve kur një studim i tillë është i lidhur ngushtë dhe është pjesë përbërëse e krijimit të një aseti, nga i cili kompania parashikon të sigurojë të ardhura me shfrytëzimin e tij. Në këtë rast, nuk jemi në momentin e përfshirjes së këtyre studimeve si pjesë e një krijimi të ndonjë aseti konkret.

- *Argumenta dhe sqarimeve për shpenzimet lidhur me 'menaxhimin e kongjestionit me ridispecerim' duke dhënë shpjegime nëse këto kosto duhet të mbulohen nga OST sh.a. apo nga tregu i balancimit. Të evidentohet në formë analitike realizimi i këtij shpenzimi për periudhën Janar - Shtator 2021 si dhe parashikimet për periudhën Tetor - Dhjetor 2021 e më tej parashikimet për vitin 2022 si dhe periudhën rregullatore të propozuar 2022 - 2024.*

Në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit, neni 134:

OST është përgjegjëse për sigurinë operacionale në zonën e vet të përgjegjësisë në aspektin e:

- a) Përdorimit të mjeteve brenda zonës së vet të përgjegjësisë, duke përfshirë operimin në kohë reale, planifikimin operacional, zhvillimin dhe shpërndarjen e aseteve dhe dhënien e zgjidhjeve për parandalimin dhe riparimin e defekteve;
- b) Përdorimit të mjeteve të mundësuar përmes bashkëpunimit me palët e tjera të interesit, duke përfshirë këtu ri-dispecimin ose ri-skedulimin dhe menaxhimin e kongjestionëve, rezervave operative dhe shërbimeve të tjera ndihmëse;

Gjithashtu, vendimi Nr 106 /2020 ERE “Mbi Miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” pika 6.5.1 citon se : *Rezervat Zëvendësuese (RR) janë rezerva të fuqisë aktive të disponueshme për të zëvendësuar njësitë generuese që pësojnë një ndërprerje të detyruar ose që përdoren për qëllime të menaxhimit të kongjestionit.*

Pika 6.5.2 e këtij vendimi citon : *Shkaku për aktivizimin e RR nga OST duhet në këtë mënyrë të kufizohet në situatat e kongjestionit që kërkojnë menaxhim efikas dhe pro-aktiv, në çdo kohë duke filluar nga mbyllja fillestare e portës së ofertave në D-1 deri në mbylljen finale të portës së ofertave.*

Si rrjedhojë për sa cituar me sipër keto kosto nuk janë kosto që mbulohen nga mekanizmi balancues, por kosto që janë përfshirë në tarifen e kërkuar nga OST.

Në lidhje me kërkesën e ERE për evidentimin analitik, ju bëjmë me dije se OST nuk e ka aplikuar deri më tani “**menaxhimin e kongjestionit me ridispecerim**”. Hyrja në fuqi e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike e kthen në detyrim për OST këtë lloj shërbimi.

Parashikimet e shpenzimeve në lidhje me këtë zë, janë pasqyruar në materialin e dërguar në kërkesën për tarifën e transmetimit.

- Argumenta dhe sqarime për vlerën e të ardhurave të kërkuara për mbulimin e kostove të parashikuara për mbulimin e shërbimeve ndihmëse, kapacitetin e parashikuar për realizimin e tyre bashke me referencat e përdorura të çmimeve sipas secilit zë për vitin 2022 si dhe periudhën rregullatore 2022 - 2024 si dhe realizimin sipas zërave analitik dhe kapacitetin faktik, çmimet e realizuara për secilin zë të vitit 2020 si dhe realizimi i këtij shpenzimi për periudhën Janar - Shtator 2021 dhe parashikimet për periudhën Tetor - Dhjetor 2021.

Gjate procesit vleresimit të mjaftueshmërisë në zonën e përgjegjësisë, OST vlerëson mundësinë e plotësimit të kërkesës totale të vendit, duke konsideruar gjenerimin disponibel në kombinim me aftësinë e linjave të interkoneksionit, me skenarë të ndryshëm operacionalë duke marrë parasysh nivelin e kërkuar të rezervave të fuqisë aktive.

Vleresimi i rezervave për shërbimet ndihmëse kryhet në përputhje me metodën deterministike dhe duke observuar vlerat e devijimeve historike.

Gjatë vitit 2020, këto shërbime janë siguruar nga KESH sh.a., me çmim të rregulluar, i cili ka qenë 270 lekë/MW

Kështu përsa i përket vitit 2021, në tabelën e mëposhtme tregohen realizimi dhe pritshmëria e realizimit të këtij zëri:

Viti 2021	Sasia Totale Viti 2021	Janar-Shtator			Trem IV	TOTAL
		MW/h	Çmimi	Vlera	Vlera	Vlera
Produkti	MW/h	MW/h	[€/MW/h]	[€]	[€]	[€]
aFRR+	244,595.60	175,595.60	10.42	1,829,852.02	1,312,647.79	3,142,499.80
aFRR-	238,671.08	164,151.08	7.02	1,152,990.42	1,171,326.63	2,324,317.05
mFRR+	143,546.00	2,786.00	9.13	25,431.40	1,330,759.23	1,356,190.63
mFRR-	450.00	450.00	6.37	2,865.00	-	2,865.00
<b>Σ</b>	<b>627,262.68</b>	<b>342,982.68</b>	<b>8.78</b>	<b>3,011,138.83</b>	<b>3,814,733.65</b>	<b>6,825,872.48</b>

Në total për vitin 2021, shpenzimet për shërbimet ndihmëse parashikohen të jenë rreth 6.8 mln Euro.

Përsa i përket referencave për çmimet e shërbimeve ndihmëse, ju sqarojmë si mëposhtë:

Çmimet aktuale nga TSHB:

Viti 2021	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Mesatare
aFRR+	15.84	17.83	13.70	14.60	15.49
aFRR-	5.85	10.16	9.08	10.54	9.93
mFRR+		9.39	9.90		9.65
mFRR-		5.90	6.90		6.40

Ndërkohë referuar <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2352484721003796>

[€/MW]	Bosnia Herzegovina		Kroacia		Serbia		RAJONI	Mesatare	Referenca per OST sh.a.
	2018	2019	2018	2019	2018	2019			2022-2024
aFRR+	10.7	10.55	11.69	13.99	10.34	12.56	13.51	12.57	14.03
aFRR-	10.7	10.55	11.69	13.99	10.34	12.56	12.4	12.02	10.97
mFRR+	2.18	1.8	6.34	7.34	6.03	7.48	3.5	4.35	7.00
mFRR-	0.25	0.18	6.34	7.34	0	0	2	2.18	4.29

Analizat dhe detajimet në lidhje me këtë çështje, janë pasqyruar në aplikim e bërë për tarifen si dhe në materialet bashkelidhur këtij materiali.



- *Argumenta dhe sqarime për mospërfshirjen në zbritje të të ardhurave të realizuara, atyre që priten të realizohen për vitin 2021 dhe periudhën pasardhëse rregullatore 2022 -2024 nga marrëveshja midis OST dhe KOSTT për prokurimin e shërbimeve ndihmese, ku vetëm për 6 mujorin e parë si deklarohet në dokumentacionin e përcjellë prej jush me anë të aplikimit në fjalë, të ardhurat janë realizuar në vlerën 186,7 mil lekë. Sa më sipër vlersojmë të nevojshme që të përcillen në ERE dhe të ardhura të tjera të zbritshme të realizuara apo që priten të realizohen nga OST sh.a. me qëllim korrigjimin e të ardhurave të kërkuara/lejuara për vitin 2022 dhe periudhën rregullatore të propozuar.*

Ne lidhje me këtë çështje, ju sqarojmë që në raportet periodike të OST sh.a., është mbajtur e evidentuar të ardhurat nga KOSTT për shërbimet ndihmëse që siguron OST sh.a. për llogari të tyre, ndërsa në analizën dhe parashikimet e bëra për periudhën 2022-2024, në zërin “shërbime ndihmëse” për sejcilin nga vitet e marra në shqyrtim, janë përllogaritur dhe evidentuar (netuar) vetëm kostot e këtij shërbimi që kanë të bëjnë me aktivitetin e OST sh.a.. Në këtë mënyrë, për periudhën 2022-2024, nuk paraqiten elementë për “korrigjimin e të ardhurave të kërkuara/lejuara për vitin 2022 dhe periudhën rregullatore të propozuar”.

Të gjitha të ardhurat e tjera të cilat nuk janë nga aktiviteti i transmetimit (alokimi i kapaciteteve, te ardhurat nga transmetimi i te dhenave, të ardhura nga grantet, të ardhurat e tjera) janë zbritur në përllogaritjen e të ardhurave të kërkuara dhe në përllogaritjet e tarifës së kërkuar të transmetimit.

- *Argumenta dhe analiza mbi mos ndryshimin e kapaciteteve totale per periudhën në fjalë në kohën kur kërkohen të realizohen investime në vlera të konsiderueshme. Në aplikim parashikimi juaj për periudhën 2022-2024 mbi shumen e kapaciteteve totale të Konsumatorëve të Kualifikuar + OSHEE është 1,450,000 kW, evidentohet i pandryshuar duke afektuar si rrjedhojë taritën e kapacitetit të kërkuar për periudhën rregullatore.*

Ne lidhje me këtë çështje, vlerësimi është bërë mbi bazën e ecurisë së kërkesës dhe parashikimin e saj për periudhën e dhënë, duke qënë se metodologjia aktuale i referohet kapaciteteve në funksion të konsumatorëve në tregun shqiptar të energjisë, dhe jo kapaciteteve të plota të sistemit të transmetimit.

- *Paraqisni për shqyrtim ne ERE, veçmas aplikimit për tarifë, planin e investimeve në rrjetin e transmetimit për periudhën rregullatore të propozuar 2022 - 2024 si dhe përditësimin e planit 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, në përputhje me përcaktimet e "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit te ERE nr. 135, datë 06.09.2017.*

Ne lidhje me këtë çështje, Plani i investimeve në rrjetin e transmetimit për periudhën rregullatore të propozuar 2022 - 2024, gjendet raport më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

Përditësimi i Planit 10-vjeçar 2015-2025 konsiston në vitin e komisionimit për objektet të cilat janë në proces apo parashikohen të përfshihen në investime nga dokumenti i miratuar në ERE me Vendim Nr.186, datë 10.11.2017. Per rrjedhoje, ne kushtet aktuale tregues i ndryshuar është viti i komisionimit. Kjo lidhur me situaten e shpalljes se gjendjes se emergjences ne furnizimin me energji elektrike dhe si pasojë e faktorëve të ndryshëm ku mund të listojmë procedurat e prokurimit, shpronësimet etj.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se OST është në procedurat e miratimit të “Masterplanit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit 2018-2033”, përfshire edhe procesin pranë Entit Rregullator të Energjisë në funksion të bazës rregullatore në fuqi.

Tabela që reflekton perditesimin e Planit 10-vjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit gjendet raport më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali..

- *Sjellim në vemendjen tuaj në zbatim pikës 5, nenit 60, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe nenit 8, pika 2 dhe pika 4 të Rregullores së Procedurave të Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve e miratuar me vendimin nr. 135/2017 të Bordit të ERE-s, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të paraqesë pranë ERE-s, së bashku me aplikimin për miratimin e tarifës, planin e përditësuar të investimeve për vitin pasardhës. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit aplikon për një tarifë për një periudhë rregullatore më të madhe se 1 vit, programi i investimeve do të përmbajë një analizë të investimeve të planifikuara për periudhën rregullatore përkatëse.*

Ne lidhje me këtë çështje, parashikimet për planin e Investimeve të vitit 2022, gjendet në raportin e cituar në pikën e mësipërme. Paraqitja formale e kërkesës për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2022, do të bëhet pasi të jetë miratuar Programi i Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2022, hartimi dhe miratimi i të cilit është i lidhur me ecurinë e procesit të miratimit të tarifës së transmetimit për vitin 2022.

- *Raport mbi investimet e realizuara dhe të futura në operim sipas grupeve të aseteve për vitin 2020, investimet e futura në operim për periudhën Janar - Shtator 2021 si dhe parashikimet për periudhën Tetor - Dhjetor 2021 mbështetur planin e investimeve të miratuar nga ERE për vitin 2020 si dhe planin e investimeve paraqitur për shqyrtim në ERE për vitin 2021 për të cilin tashmë Bordi i ERE ka filluar procedurat me vendimin nr. 148/2021.*

Informacioni për realizimin e investimeve gjatë vitit 2021 si dhe kapitalizimet e investimeve për vitin 2021 gjendet pjesë më vete bashkëlidhur këtij materiali.

- *Shpenzimet për penalitete, të cilat pavarësisht mospërfshirjes në llogaritjen e tarifës së transmetimit duhet të deklarohen nga shoqëria në mënyrë analitike sipas objektit.*

Ne lidhje me këtë çështje, në tabelën e mëposhtme pasqyrohen në mënyrë analitike shpenzimet për penalitete:

#### **Gjoha dhe dëmshpërblime 2020**

<b>Pershkrim</b>	<b>Viti 2020</b>
Demshperblime ceshtjet gjyqesore	3,096,742.00
Penalitet per pagese me vonese te huave te marra nga KESH sha	1,783,738.67
Penalitet per pagese me vonese te huave te marra nga MFE	148,284,250.03
<b>TOTALI</b>	<b>153,164,730.70</b>

#### **Gjoha dhe dëmshpërblime 2021**

<b>Pershkrim</b>	<b>Janar - Shtator 2021</b>
Demshperblime ceshtjet gjyqesore	6,827,483.10
Penalitete per mosdorezim te pasqyrave financiare ne tatime dhe QKB	35,000.00
<b>TOTALI</b>	<b>6,862,483.10</b>

- *Informacion të detajuar mbi treguesit e kredive të marra nga OST sh.a dhe kreditë e parashikuara për të aplikuar gjatë vitit 2022. si p.sh, afati, financuesi, detyrimi aktual ose pjesa e likuiduar etj, informacion i cili duhet të jetë i shoqëruar me argumenta dhe dokumenta sqarues për të bërë te mundur vlerësimin dhe analizimin e drejtë lidhur me koston e borxhit si dhe destinacionin e përdorimit të këtyre fondeve.*

Informacion të detajuar mbi treguesit e kredive të marra nga OST sh.a dhe kreditë e parashikuara, gjenden bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

- *Përlllogaritjet e kostos së borxhit sipas përcaktimeve të Metodologjisë përkatëse për vitin 2021, vitin 2022 si dhe për periudhën rregullatore 2022 - 2024.*

Informacioni i detajuar mbi këtë çështje, gjendet bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

- *Argumenta dhe sqarimet përkatëse lidhur me ndryshimin e komponentëve të AROE të paraqitur dhe të marrë në konsideratë për vitin 2020, vitin aktual dhe vitin 2022 e më tej për periudhën 2022 - 2024. Gjithashtu duhet të dërgohet një analizë duke evidentuar përlllogaritjet e WACC të krahasuar me metodologjitë që përdoren nga vendet e tjera në rajon apo BE lidhur me kthimin e kërkuar mbi asetet, apo krahasimet me praktikën më të mira të kompanive të rregulluara të rajonit të cilat janë të krahasueshme me OST sh.a. (benchmark).*


Duke ju referuar Metodologjisë së Llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, përse i përket komponentit AroE, në nenin 7, pika 4.4, thuhet se “Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazën e nevojës së OST-së për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit afatgjatë duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve në vitin bazë. Gjithë fitimet duhen përdorur për të mbështetur programin e shpenzimeve kapitale të OST-së dhe për të rritur vlerën e kontabilizuar të pjesës së kapitalit”. Duke mos patur një normë të tillë të vendosur nga rregullatori për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024, nga ana e OST sh.a., është vlerësuar një normë minimale për komponentin AROE i cili është marrë për bazë në aplikimin e OST sh.a. për tarifën e transmetimit.

Gjithashtu, në Metodologjinë e Llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, në nenin 7, pika 4.5, thuhet se “Nëse OST-ja mund të demonstrojë se ka një nevojë urgjente për shpenzime kapitale specifike dhe se financimi i borxhit afatgjatë për këto asete apo fluksi i parasë nuk është i mjaftueshëm për ti shërbyer borxheve të arsyeshme/të justifikuar, ERE-ja mund të vendosë të caktojë një normë të lartë tv lejueshme të kthimit të kapitalit dhe ta mundësojë në këtë mënyrë OST-në që të gjenerojë fluksin shtesë të parave që nevojiten”. Në vlerësimin tonë, nevoja emergjente për shpenzime kapitale si dhe fluksi i parasë i pamjaftueshëm për ti shërbyer borxheve mund të jenë elementë të mjaftueshëm për të caktuar një normë më të lartë të kthimit të kapitalit.

Për më tepër, nga një vështrim i treguesit të WACC në vëndet e tjera, vihet re që vlera e WACC të OST sh.a., për efekt të llogaritjes së tarifave është mjaft e ulët në krahasim me vëndet tjera. Duke ju referuar Raportit të CEER (Council of European Energy Regulators), të publikuar me datë 11 Mars 2021, në mënyrë të përmbledhur kjo normë për vëndet e tjera paraqitet si mëposhtë:

Shteti	WACC per OST
Angli	7.00%
Austri	8.16%
Belgjike	5.76%
Çeki	10.28%
Estoni	5.65%
Finlande	7.06%
France	9.70%
Gjermani	6.91%
Greqi	8.30%
Hollande	6.70%
Hungari	6.20%
Irlande	9.51%
Islanda	6.65%
Itali	5.30%
Kroaci	4.03%
Letoni	6.76%
Lituani	8.58%
Luksemburg	6.12%
Norvegji	12.00%
Poloni	6.75%
Portugali	7.90%
Rumani	6.90%
Sllovaki	10.71%
Slloveni	5.26%
Spanje	6.40%
Suedi	5.44%

Norma e WACC per Kompanite e Transmetimit te Energjise (%)



- Të plotësohet informacioni i paraqitur mbi bazën e rregulluar të asetëve dhe amortizimin e akumuluar për çdo grup asetësh, shtesat e asetëve të kapitalizuara në formë analitike të cilat i përkasin aktivitetit të transmetimit, llogaritjet e amortizimit të akumuluar sipas vlerës historike të asetëve si dhe vlera e asetëve që pritet të futet në operim për vitin 2022 e më tej për periudhën rregullatore 2022-2024. Gjithashtu, në të dhënat që duhet të dërgohen bëhet e nevojshme dhe paraqitja e analizave apo raporteve për jetën operuese të asetëve apo një analizë të vlerës së amortizimit të akumuluar të llogaritur për të gjitha asetet që përfshihen në bazën e rregulluar të asetëve përgjatë vitit të fundit të periudhës koherente dhe vlerësimin e saj për periudhën e ardhshme rregullatore.

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet informacioni mbi bazën e rregulluar të asetëve dhe amortizimin për çdo grup asetësh, shtesat e asetëve të kapitalizuara të cilat i përkasin aktivitetit të transmetimit.

Viti 2020						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve (Leke)	Amortizimi vjetor (Leke)	Amortizimi i akumuluar (Leke)	Vlera neto e asetëve (Leke)
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licenca	205/208	713.702.640	158.445.446	310.885.039	402.817.601
2	Toka	211	2.937.091.946	10.610.083	21.220.167	2.915.871.780
3	Ndertesa	212	2.542.932.367	67.623.020	136.673.568	2.406.258.799
4	Instalime, makineri dhe Paisje te tjera	213	45.537.156.831	1.983.616.139	4.124.593.666	41.412.563.166
5	Mjete transporti	215	402.386.380	43.788.466	95.304.647	307.081.733
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	770.739.028	103.656.742	199.555.483	571.183.545
<b>TOTAL</b>			<b>52,904,009,193</b>	<b>2,367,739,896</b>	<b>4,888,232,570</b>	<b>48,015,776,623</b>

Viti 2021						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve (Leke)	Amortizimi vjetor (Leke)	Amortizimi i akumuluar (Leke)	Vlera neto e asetëve (Leke)
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licenca	205/208	713.702.640	162.272.150	473.157.189	240.545.450
2	Toka	211	2.937.091.946	10.610.083	31.830.250	2.905.261.696
3	Ndertesa	212	2.579.436.017	68.459.562	205.133.130	2.374.302.887
4	Instalime, makineri dhe Paisje te tjera	213	47.742.318.362	2.008.490.283	6.133.083.949	41.609.234.413
5	Mjete transporti	215	402.386.380	43.788.466	139.093.113	263.293.267
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	867.837.841	111.365.867	310.921.350	556.916.491
<b>TOTAL</b>			<b>55,242,773,186</b>	<b>2,404,986,411</b>	<b>7,293,218,981</b>	<b>47,949,554,205</b>

Viti 2022						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve (Leke)	Amortizimi vjetor (Leke)	Amortizimi i akumuluar (Leke)	Vlera neto e asetëve (Leke)
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licenca	205/208	861.702.640	127.412.576	600.569.765	261.132.875
2	Toka	211	2.937.091.946	10.610.083	42.440.334	2.894.651.613
3	Ndertesa	212	2.579.436.017	68.459.562	273.592.692	2.305.843.325
4	Instalime, makineri dhe Paisje te tjera	213	54.372.432.878	2.319.124.087	8.452.208.036	45.920.224.842
5	Mjete transporti	215	542.578.130	43.788.466	182.881.578	359.696.552
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	867.837.841	116.834.135	427.755.484	440.082.356
<b>TOTAL</b>			<b>62,161,079,452</b>	<b>2,686,228,908</b>	<b>9,979,447,889</b>	<b>52,181,631,563</b>

Viti 2023						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve (Leke)	Amortizimi vjetor (Leke)	Amortizimi i akumuluar (Leke)	Vlera neto e asetëve (Leke)
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licenca	205/208	861,702,640	88,209,431	681,677,417	180,025,223
2	Toka	211	2,937,091,946	10,610,083	53,050,417	2,884,041,530
3	Ndertesa	212	2,579,436,017	68,459,562	342,052,254	2,237,383,763
4	Instalime, makineri dhe Paisje te tjera	213	59,586,001,470	2,498,975,609	10,951,183,645	48,634,817,825
5	Mjete transporti	215	542,578,130	43,788,466	226,670,044	315,908,086
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	955,337,841	119,852,606	547,608,090	407,729,750
<b>TOTAL</b>			<b>67,462,148,044</b>	<b>2,829,895,758</b>	<b>12,802,241,867</b>	<b>54,659,906,178</b>

Viti 2024						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve (Leke)	Amortizimi vjetor (Leke)	Amortizimi i akumuluar (Leke)	Vlera neto e asetëve (Leke)
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licenca	205/208	861,702,640	24,981,379	699,557,016	162,145,624
2	Toka	211	2,937,091,946	10,610,083	63,660,500	2,873,431,446
3	Ndertesa	212	2,579,436,017	68,459,562	410,511,815	2,168,924,201
4	Instalime, makineri dhe Paisje te tjera	213	63,841,775,214	2,652,650,046	13,603,833,691	50,237,941,523
5	Mjete transporti	215	542,578,130	43,788,466	270,458,510	272,119,620
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	1,042,837,841	123,012,199	670,620,290	372,217,551
<b>TOTAL</b>			<b>71,805,421,788</b>	<b>2,923,501,735</b>	<b>15,718,641,822</b>	<b>56,086,779,967</b>

- *Nisur nga fakti se shoqëria propozon një tarifë të ndryshme nga ajo në fuqi, duhet të përshkruajë dhe analizojë arsyet për këto ndryshime, efektet që do të kenë ndryshimet e propozuara, si do të afektohen grupet e klientëve të lidhur në secilin nivel tensioni dhe metodotat e aplikuara për të korrigjuar efektet e realizimit të tyre ndaj taritës në fuqi.*

Ne lidhje me këtë çështje, sqarojmë se nga ana e shoqërisë nuk është propozuar një tarifë e ndryshme nga ajo në fuqi. Në aplikimin e saj, shoqëria është mbështetur në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, e vila në përmbajtjen e saj parashikon Ndarjen e kostove për kapacitet dhe energji (neni 8) si dhe Llogaritjen e tarifës mesatare të transmetimit Neni 9).

Duhet theksuar fakti që mbështetur në metodologjinë aktuale, mbulimi i të ardhurave të kërkuara, është fokusuar tek konsumi dhe konsumatorët. Si e tillë, ndarja ose jo e tarifës për kapacitet dhe energji, ngarkon në të njëjtën mënyrë furnizuesit dhe konsumin.

Nga ana e OST sh.a., do të rekomandohej rishikimi i metodologjisë duke vënë në fokus përdoruesit e rrjetit të transmetimit si dhe kostove të shërbimeve të transmetimit, duke bërë kështu të mundur alokimin e të ardhurave të kërkuara sipas tipit të përdoruesve, dhe shpërndarjen më të drejtë të të ardhurave të kërkuara sipas shfrytëzimit rëspëktiv të rrjetit të transmetimit.

- *Informacion mbi huatë e marra për secilën periudhë rregullatore, qëllimin e tyre si dhe të evidentoni investimet e kryera apo që priten të kryhen të shoqëruara me marrveshjet e huave përkatëse si dhe planin e shlyerjes së këtyre huave për vitin 2020, pritshmërinë e vitit 2021 si dhe për periudhën rregullatore të propozuar 2022-2024 të ndara nga huatë të cilat janë detyrim për tu shlyer nga OSHEE në zbatim të vendimeve respektive të ERE-s.*

Informacioni i detajuar mbi këtë çështje, gjendet bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali. Vendimet e ERE, për shlyerjen e detyrimeve të huave nga OSHEE, i referohen listës së plotë të detyrimeve për huatë, informacionin për të cilat është bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

- Gjithë kostot me saktësi deri në 100,000 lekë, në përputhje me percaktimet e "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar nga ERE me vendimin 180/2017.

Ne lidhje me këtë çështje, gjykojmë që në materialet e dërguara me aplikimin si dhe me informacionin që përmban ky material, janë pasqyruar të gjitha kostot që kanë të bëjnë me aktivitetin e OST sh.a.

- Të paraqesë në formatin excel çdo llogari për të gjithë evidencat e paraqitura në aplikimin për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën rregullatore 2022-2024 me formulat përkatëse.

Ne lidhje me këtë çështje, të gjitha file të përlogaritjeve dhe evidencave të paraqitura në aplikimin për tarifën e transmetimit, gjenden bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali;

### Në përfundim,

Duke u bazuar në sqarimet dhe materialet e dërguara me parë për aplikim për tarifën e transmetimit si dhe në vijim të sqarimeve, përditësimeve dhe dokumentacionit shoqërues dhe pjesë e këtij materiali, si dhe në mbështetje të metodologjisë aktuale të llogaritjes së tarifës së transmetimit, nga ana e OST sh.a., janë pasqyruar efektet në llogaritjen e tarifës së transmetimit.

Kështu përta i takon vitit 2021, vlerësimet tregohen si më poshtë:

Përshkrimi	Njesia	2020		2021		Të ardhurat e munguara		
		Tarifa Aktuale	Tarifa sipas Metod.	Tarifa Aktuale	Tarifa sipas Metod.	2020	2021	2020-2021
C = C kapital + C operuese - Të ardhurat nga aktivitetet tjera	Mln. leke	5,270	5,813	5,745	8,171	543	2,914	3,457
<b>I. C kapital= R+D</b>	Mln. leke	3,954	4,497	1,543	4,458			
<b>1 Kthimi mbi kapitalin (R = B*wacc)</b>	Mln. leke	1,558	2,101	-862	2,053			
<b>a. B (Baza e rregulluar e asetëve)</b>	""	49,082	49,082	48,015	48,015			
<b>b. WACC = [ES * ARoE/ (1-T)] + (DS * CoD)</b>	%	3.17%	4.28%	-1.79%	4.28%			
ES - Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB	""	61.26%	61.26%	63.44%	63.44%			
T - Norma e taksës së korporatës	""	15.00%	15.00%	15.00%	15.00%			
ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	""	2.46%	4.00%	-2.77%	4.00%			
DS - Objektivi për raportin e borxhit në RAB	""	38.74%	38.74%	36.56%	36.56%			
CoD - Kosto e borxhit	""	3.61%	3.61%	3.53%	3.53%			
<b>2 Amortizimi i vitit (D)</b>	Mln. leke	2,396	2,396	2,405	2,405			
<b>II. C operuese</b>	""	3,064	3,064	5,902	5,902			
1 Personeli	""	1,168	1,168	1,388	1,388			
2 Shërbime administrative e të tjera	""	642	642	606	606			
3 Materiale të para	""	79	79	118	118			
4 Blerja e shërbimeve ndihmese	""	152	152	832	832			
5 Blerja e humbjeve	""	843	843	2,672	2,672			
6 Paguesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	""	180	180	286	286			
<b>III. Te ardhurat nga aktivitetet te tjera</b>	""	(1,748)	(1,748)	(1,700)	(1,700)			
E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)	GWh	7,027	7,027	7,660	7,660	7,027	7,660	14,687
<b>Tarifa mesatare e transmetimit</b>	Lek/kWh	0.75	0.83	0.75	1.13	0.08	0.38	0.24

Nga përlogaritjet e bëra, të ardhurat e munguara për vitet 2021-2022, janë në masën **3,457** milionë lekë ose **0.24 leke/kWh**, e cila duhet të merret në konsideratë nga ERE për tu përfshirë në rishikimin e tarifave.

Përsa i takon viteve 2022 - 2024, vlerësimet e rishikuara tregohen si më poshtë:

Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë		2022	2023	2024
Përshkrimi	Njësia			
C = C kapital + C operuese - Të ardhurat nga aktivitetet të tjera		11,876	11,326	11,242
C kapital= R+D		4,760	5,032	5,251
<b>I.</b>	<b>1 Kthimi mbi kapitalin (R = B*wacc)</b>	<b>Milion Leke</b>	<b>2,073</b>	<b>2,327</b>
<b>a.</b>	<b>B (Baza e rregulluar e asetëve)</b>	'''	<b>47,950</b>	<b>52,182</b>
<b>b.</b>	<b>WACC = [ES * ARoE/ (1-T)] + (DS * CoD)</b>	%	<b>4.32%</b>	<b>4.22%</b>
	ES - Objektiv i për raportin e kapitalit të vet në RAB	'''	62.14%	60.35%
	T - Norma e takses së korporatës	'''	15.00%	15.00%
	ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	'''	4.00%	4.00%
	DS - Objektiv i për raportin e borxhit në RAB	'''	37.86%	39.65%
	CoD - Kosto e borxhit	'''	3.70%	3.48%
<b>2</b>	<b>Amortizimi i vitit (D)</b>	<b>Milion Leke</b>	<b>2,686</b>	<b>2,830</b>
<b>II.</b>	<b>C operuese</b>	'''	<b>8,501</b>	<b>7,727</b>
1	Personeli	'''	1,416	1,473
2	Shërbime administrative e të tjera	'''	733	711
3	Menaxhimi i kongjestionit me ridispecim	'''	521	558
4	Materiale të para	'''	132	134
5	Blerja e shërbimeve ndihmëse	'''	1,708	1,924
6	Blerja e humbjeve	'''	3,741	2,705
7	Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	'''	250	250
<b>III.</b>	<b>Te ardhurat nga aktivitetet e tjera</b>	'''	<b>(1,385)</b>	<b>(1,433)</b>
	E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjerë)	GWh	7,720	7,795
	<b>Tarifa mesatare e transmetimit</b>	<b>Lek/kWh</b>	<b>1.54</b>	<b>1.45</b>
				<b>1.43</b>

Tarifa mesatare 3 vjeçare e transmetimit për llogaritjet të jetë **1.47 leke/kWh**

Siç dhe është cituar më lart, nga ana e OST sh.a., do të rekomandohej rishikimi i metodologjisë duke vënë në fokus përdoruesit e rrjetit të transmetimit si dhe kostove të shërbimeve të transmetimit, duke bërë kështu të mundur alokimin e të ardhurave të kërkuara sipas tipit të përdoruesve, dhe shpërndarjen më të drejtë të të ardhurave të kërkuara sipas shfrytëzimit rëspëktiv të rrjetit të transmetimit.

Duke marrë në konsideratë këtë metodologji të mundëshme, nga ana e OST sh.a., është bërë dhe një vlerësim, ku qasje dhe ndryshimet nga metodologjia aktuale, pasqyrohen si mëposhtë:

VITI 2022											
Sasia e levruar GWh	Metodologjia Aktuale		Metodologjia e Mundshme								
	Tarifa Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Total		TRANSMETIM		OPERIM		TREGU		
			Tarifa mesatare Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Tarifa Transmetimi mit Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Tarifa Operimit Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Tarifa Tregut Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	
OSHEE+Furnizuesit e kualifikuar	7,720	1.54	11,876	1.34	10,339	0.95	7,301	0.39	3,001	0.005	37
Prodhuesit eksport + Tregtaret tranzit	1,625	0	0	0.95	1,537	0.95	1,537	-	0	-	0
<b>TOTALI</b>	<b>9,345</b>	<b>-</b>	<b>11,876</b>	<b>1.27</b>	<b>11,876</b>	<b>-</b>	<b>8,838</b>	<b>-</b>	<b>3,001</b>	<b>-</b>	<b>37</b>

VITI 2023											
Sasia e levruar GWh	Metodologjia Aktuale		Metodologjia e Mundshme								
	Tarifa Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Total		TRANSMETIM		OPERIM		TREGU		
			Tarifa mesatare Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Tarifa Transmetimi mit Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Tarifa Operimit Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Tarifa Tregut Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	
OSHEE+Furnizuesit e kualifikuar	7,795	1.45	11,326	1.28	9,953	0.85	6,651	0.42	3,265	0.005	37
Prodhuesit eksport + Tregtaret tranzit	1,610	0	0	0.85	1,374	0.85	1,374	-	-	-	0
<b>TOTALI</b>	<b>9,405</b>	<b>-</b>	<b>11,326</b>	<b>1.20</b>	<b>11,326</b>	<b>-</b>	<b>8,025</b>	<b>-</b>	<b>3,265</b>	<b>-</b>	<b>37</b>

VITI 2024											
Sasia e levruar GWh	Metodologjia Aktuale		Metodologjia e Mundshme								
	Tarifa Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Total		TRANSMETIM		OPERIM		TREGU		
			Tarifa mesatare Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Tarifa Transmetimi mit Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Tarifa Operimit Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	Tarifa Tregut Leke/kWh	Te ardhurat e Kërkuara Mln leke	
OSHEE+Furnizuesit e kualifikuar	7,870	1.43	11,242	1.25	9,837	0.81	6,357	0.44	3,442	0.005	38
Prodhuesit eksport + Tregtaret tranzit	1,740	0	0	0.81	1,406	0.81	1,406	-	-	-	0
<b>TOTALI</b>	<b>9,610</b>	<b>-</b>	<b>11,242</b>	<b>1.17</b>	<b>11,242</b>	<b>-</b>	<b>7,763</b>	<b>-</b>	<b>3,442</b>	<b>-</b>	<b>38</b>



PERIUDHA 2022 - 2024											
Sasia e levruar GWh	Metodologjia Aktuale		Metodologjia e Mundshme								
	Tarifa Leke/kWh	Te ardhurat e Kerkuara Mln leke	Total		TRANSMETIM		OPERIM		TREGU		
			Tarifa mesatare Leke/kWh	Te ardhurat e Kerkuara Mln leke	Tarifa Transmetimi Leke/kWh	Te ardhurat e Kerkuara Mln leke	Tarifa Operimit Leke/kWh	Te ardhurat e Kerkuara Mln leke	Tarifa Tregut Leke/kWh	Te ardhurat e Kerkuara Mln leke	
OSHEE+Furnizuesit e kualifikuar	23,385	1.47	34,444	1.29	30,128	0.87	20,309	0.42	9,708	0.005	111
Prodhuesit eksport + Tregtarët tranzit	4,975	0	0	0.87	4,316	0.87	4,316		0		0
<b>TOTALI</b>	<b>28,360</b>	<b>-</b>	<b>34,444</b>	<b>1.21</b>	<b>34,444</b>	<b>0.87</b>	<b>24,625</b>		<b>9,708</b>		<b>111</b>

Metodologjia aktuale, parashikon një tarifë mesatare të fokusuar vetëm tek furnizuesit e energjisë elektrike për konsumin vëndas. Në këtë rast, të ardhurat e kërkuara dhe tarifa mesatare e transmetimit për vitet 2022-2024 do të duhej të ishte respektivisht 34.4 miliardë lekë si të ardhura të kërkuara dhe 1.47 leke/kWh si tarifë transmetimi.


Në vlerësimet e metodologjisë së propozuar, të ardhurat e kërkuara do të mund të ndaheshin sipas përdoruesve të rrjetit. Kështu, të ardhurat e kërkuara prej 34.4 miliardë lekë për vitet 2022-2024, do të mund të ndaheshin në 30.1 miliardë lekë për furnizuesit dhe 4.3 miliardë lekë për prodhuesit dhe/ose tregtarët të cilët përdorin rrjetin e transmetimit për transaksione të energjisë elektrike jashtë kufijve të vendit.

Sipas metodologjisë së propozuar, tarifa e transmetimit do të kishte 3 komponentë, të cilët i takojnë shërbimeve të transmetimit (Transmetim; Operim dhe Treg). Për përdoruesit e rrjetit të transmetimit në funksion të tregut të brendshëm të energjisë, do të mund të aplikoheshin 3 komponentet e tarifës.

Për përdoruesit e rrjetit të transmetimit në funksion të tregut të jashtëm të energjisë, do të mund të aplikoheshin vetëm tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit.

Sipas përlllogaritjeve, tarifa mesatare e Furnizuesve do të mund të ishte 1.29 lekë/kWh (0.87 lekë/kWh – Transmetimi; 0.42 lekë/kWh – Operimi; 0.005 lekë/kWh – Tregu), ndërsa për Prodhuesit dhe tregtarët që japin energji jashtë vëndit tarifa do të mund të ishte 0.87 lekë/kWh.

Në mënyrë të përmbledhur, ndryshimet dhe ndikimet që ka metodologjia e mundëshme e propozuar nga ajo aktuale persa i përket furnizuesve të energjisë elektrike në vënd, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Sic shihet dhe në grafik, për periudhën 2022-2024, të ardhurat e kërkuara për furnizuesit do të mund të jenë rreth 4.3 miliardë lekë më pak sipas metodologjisë së re të propozuar. Cmimi mesatar për furnizuesit do të mund të jetë rreth 13% më i ulët sipas metodologjisë së re të propozuar.

Vlera prej 4.3 miliardë lekë, do të mund të ngarkohej ndaj përdoruesve të rrjetit të transmetimit, për transaksionet e energjisë elektrike që këta të fundit kryejnë duke përdorur rrjetin shqiptar të transmetimit të cilat mund të jenë në formën e eksportit të energjisë elektrike, tranzitimin dhe/ose

depozitim e energjisë elektrike jashtë kufijve të rrjetit shqiptar të transmetimit. Përdoruesit e rrjetit të transmetimit të transmetimit duhet të paguajnë një tarifë transmetimi.

Bashkëlidhur këtij materiali do të gjeni:

- *Listat e llogarive të shoqërisë në zbatim të “Sistemit të njehsuar dhe te standartizuar te llogarive për të licensuarit”;*
- *Pasqyrat Financiare të vitit 2020 sëbashku me Raportin e Audituesve Ligjorë;*
- *Raporti i aktivitetit të Veprimtarisë së OST sh.a. për vitin 2020;*
- *Raporti i Aktivitetit të Veprimtarisë së OST sh.a. për periudhën Janar-Shtator 2021, si dhe parashikimet për periudhën Tetor - Dhjetor 2021;*
- *Evidenca te komunikimeve dhe rakordimeve me përdoruesit e rrjetit mbi parashikimet e kërkesës;*
- *Plani i investimeve në rrjetin e transmetimit për periudhën rregullatore të propozuar 2022 – 2024;*
- *Përditësimi i Planit 10-vjeçar 2015-2025;*
- *Realizimi i investimeve gjatë vitit 2021 si dhe kapitalizimet e investimeve për vitin 2021;*
- *Informacion mbi treguesit e kredive të marra nga OST sh.a. dhe gjëndja e detyrimeve;*
- *Përlllogaritjet e kostos së borxhit për vitet 2022-2024;*
- *Të gjitha file të përlllogaritjeve dhe evidencave të paraqitura në aplikimin për tarifat e transmetimit.*

Mbetemi në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm

Duke ju Falenderuar,

Me respekt,

**ADMINISTRATORI I OST sh.a.**



**Skërdi Drenova**